



USHTRIA



Viti i 79-të i botimit Nr. 8 (827964)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 27 shkurt 2026



Shqipëria ringre industrinë ushtarake, ministri Vengu: Prodhim dronësh, anijesh luftarake dhe 1 000 rekrutime të reja në Forcat e Armatosura

» faqe 3



SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI: ANGAZHIM I PALËKUNDUR I FA NË MISIONIN E KFOR

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim me Shefin e Shtabit të KFOR-it, Kundëradmiral Maximilian Clark, ku u diskutua mbi situatën e sigurisë në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjatë takimit, bashkëbiseduesit vlerësuan rolin e rëndësishëm të misionit të KFOR-it në ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm në Kosovë...

faqe 4



NGA TIRANA NË FLOTËN E SHBA-së: KOMANDANT ALBAN DERVISHI, SHQIPTARI QË NDRIÇON NË KARRIERËN USHTARAKE AMERIKANE

Komandant Alban Dervishi është lindur në Tiranë dhe emigroi në Queens, Nju Jork, për të ndjekur 'Ëndrrën Amerikane'. Pas përfundimit të shkollës së mesme, ai u regjistrua në Forcat Detare në vitin 2001 dhe mori gradën 'oficer' në vitin 2009, përmes Shkollës së Kandidatëve për Oficerë (Officer Candidate School). Komandant Dervishi përfundoi studimet Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare, me nënspecializim në Studime Rajonale...

faqe 8



KATËR VITE LUFTË NË UKRAINË: NJË PLAGË E HAPUR NË ZEMËR TË EVROPËS

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Katër vite nga dita kur Rusia nisi pushtimin në shkallë të gjerë ndaj Ukrainës, duke tronditur jo vetëm rendin evropian të sigurisë, por edhe vetë arkitekturën globale të marrëdhënieve ndërkombëtare. Katër vite më pas, kjo luftë nuk është më vetëm një konflikt territorial, ajo është shndërruar në një përballje...

faqe 6



Budapest – Hungaria po dëshmon se investimi i qëndrueshëm në inovacion dhe në industrinë e mbrojtjes prodhon kapacitete reale dhe vlerë strategjike për Evropën Qendrore. Në këtë frymë bashkëpunimi dhe zhvillimi, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, **Pirro Vengu**, zhvilloi një vizitë zyrtare në Budapest, ku u takua me homologun e tij hungarez, **Kristóf Szalay-Bobrovniczky**.

Në kuadër të vizitës, delegacioni shqiptar zhvilloi një takim në zyrat qendrore të **“Pro Patria Electronics”**, kompani e njohur për ekspertizën e saj në fushën e radarëve dhe sistemeve për mbrojtjen e infrastrukturave kritike. Gjatë takimit, u prezantuan nga afër kapacitetet teknologjike dhe modeli i zhvillimit industrial që kjo kompani përfaqëson, si një shembull i integritimit të suksesshëm të kërkimit shkencor me prodhimin ushtarak.

Synimi i kësaj vizite është integrimi i industrisë shqiptare të mbrojtjes në zinxhirët e furnizimit dhe inovacionit të vendeve aleate, me qëllim ndërtimin e aftësive të qëndrueshme, të besueshme dhe plotësisht ndërvepruese për forcimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Konferencë e përbashkët për shtyp dhe riafirmim i partneritetit

Pas takimit dypalësh në Budapest, ministrat zhvilluan një konferencë të përbashkët për shtyp, ku riafirmuan partneritetin e ngushtë mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe integritimit evropian.

Në fjalën e tij, ministri Vengu falënderoi homologun hungarez dhe ekipin e tij për mikpritjen dhe bashkëpunimin intensiv të viteve të fundit, duke theksuar se Shqipëria dhe Hungaria kanë ndërtuar një partneritet të konsoliduar në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ai nënvizoi se investimet dhe kompanitë e ekselencës hungareze në Shqipëri përbëjnë tashmë një shtyllë të rëndësishme edhe për bashkëpunimin në rrafshin ushtarak.

Ministri i Mbrojtjes Vengu vlerësoi gjithashtu mbështetjen e fortë të Hungarisë për anëtarësimin e Shqipërisë në **Bashkimin European**, duke theksuar se vendi ka hapur të gjithë grup-kapitujt dhe po avancon me reformat dhe arritjen e piketave të ndërmjetme.

“Na duhet mbështetja e të gjitha vendeve anëtare që ky proces, jo vetëm teknik por edhe politik, të vijojë pa vonesë”, – u shpreh ai.

Marrëveshje për bashkëpunim dhe inovacion në mbrojtje

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe industrisë ushtarake. Ministri Vengu vlerësoi zhvillimin e industrisë hungareze të mbrojtjes dhe theksoi synimin për ndërthurjen e zinxhirëve të furnizimit ushtarak, me preferencë për vendet aleate.

Në këtë kuadër, palët nënshkruan dy marrëveshje të rëndësishme:

- **Një marrëveshje për intensifikimin e bashkëpunimit në Mbrojtje në nivel civil;**
- **Një marrëveshje mes institucioneve përgjegjëse për Inovacionin në Mbrojtje, me synimin për të përfutur më shumë financime nga programet evropiane.**

Këto marrëveshje synojnë të rrisin kapacitetet teknologjike, të forcojnë ndërveprueshmërinë dhe të krijojnë mundësi konkrete për industrinë shqiptare të mbrojtjes në tregun evropian.

Rëndësia strategjike e Evropës Juglindore

Në deklaratën e tij, ministri Vengu theksoi

Shqipëri – Hungari thellojnë bashkëpunimin në mbrojtje dhe inovacion ushtarak



rëndësinë strategjike të Evropës Juglindore për sigurinë e kontinentit, duke deklaruar se:

“Shqipëria nuk është periferi e Evropës, por pjesë e qendrës nervore të saj”. Ai kujtoi gjithashtu

angazhimin e përbashkët të Shqipërisë dhe Hungarisë në misionet ndërkombëtare, përfshirë **KFOR** dhe misionin e Bashkimit European në Bosnjë dhe Hercegovinë, duke theksuar kontributin e përbashkët për stabilitetin rajonal dhe sigurinë euroatlantike.

Nga ana e tij, ministri hungarez Kristóf Szalay-Bobrovniczky u shpreh i kënaqur për zhvillimin e takimit dypalësh dhe për bashkëpunimin me Shqipërinë, si vend anëtar i **NATO-s** dhe vend evropian me rol të rëndësishëm në rajon. Ai theksoi se Ballkani Perëndimor ka një rol kyç historik, ekonomik dhe social dhe vlerësoi Shqipërinë për angazhimin e saj në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

Vizita në Budapest dhe marrëveshjet e nënshkruara konfirmojnë një fazë të re të thellimit të bashkëpunimit strategjik mes Shqipërisë dhe Hungarisë, me fokus të veçantë në inovacionin, industrinë e mbrojtjes dhe forcimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura.



Ministri Vengu: Industri ushtarake “Made in Albania”, 326 vende të reja pune dhe forcim i kapaciteteve operationale

*Shqipëria ringre industrinë ushtarake: Prodhim dronësh, anijesh
luftarake dhe 1 000 rekrutime të reja në Forcat e Armatosura*

Shqipëria po hyn në një fazë të re të zhvillimit të industrisë ushtarake dhe fuqizimit të Forcave të Armatosura, me investime konkrete në prodhim, rritje të personelit dhe zgjerim të kapaciteteve në fushën e mbrojtjes dhe emergjencave civile.

Në një konferencë për shtyp, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, deklaroi se vendi po hedh hapa të qartë drejt ndërtimit të një industrie ushtarake funksionale, me linja prodhimi për dronë, uniforma, municione dhe mjete xheniere, duke synuar jo vetëm forcimin e sigurisë kombëtare, por edhe rritjen e punësimit dhe transferimin e teknologjisë.

326 vende të reja pune në industrinë e mbrojtjes

Sipas ministrit, gjatë këtij viti parashikohet hapja e 326 vendeve të reja pune në industrinë e mbrojtjes. Rekrutimet kanë nisur për sektorin e municioneve, uniformave dhe dronëve, ku 49 vende janë për inxhinierë dhe 68 për teknikë të diplomuar në shkollat profesionale.

Në mes të prillit do të nisë linja e assemblimit të sistemeve të dronëve në uzinën e autotraktorëve. Aktualisht po rekrutohen 12 inxhinierë dhe personel teknik, ndërsa në bashkëpunim me kompaninë shtetërore KAYO dhe Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes po zhvillohen ture informuese në universitete për tërheqjen e të rinjve.

Në muajin maj përfundon ndërtimi i fabrikës së tekstileve “Guna Tactical” në Babrru, ku do të nisë prodhimi i uniformave për Policinë e Shtetit dhe njësitë e veçanta të Forcave të Armatosura. Ndërsa në korrik parashikohet nisja e prodhimit të municioneve, pas certifikimit nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është marrëveshja e kompanisë “TIMAK Defence” me një kompani bijë të gjigantit gjerman “Rheinmetall”, në bashkëpunim me prodhuesin MAN, për prodhimin e mjeteve të transportit të komandës mbështetëse.

Po ashtu, janë finalizuar negociatat me kompaninë italiane “Fincantieri” për prodhimin e anijeve luftarake në bazën e Pashalimanit, duke hapur rrugën për krijimin e një kompanie të përbashkët.

Ministri theksoi se qëllimi është që katër kompanitë prodhuese me pjesëmarrje shtetërore të jenë konkurrese jo vetëm për furnizimin e Forcave të Armatosura, por edhe për eksport.

Rekrutim dinamik dhe rritje e kapitalit njerëzor

Në fokus mbetet edhe kapitali njerëzor. Vengu bëri të ditur se Forcat e Armatosura po kalojnë një proces intensiv rekrutimi me tre faza gjatë vitit. Faza e parë është mbyllur me 252 kandidatë që kanë nisur stërvitjen, ndërsa në 14 muajt e fundit janë shtuar rreth 1 000 efektivë aktivë.

Në mars-prill do të zhvillohet faza e dytë me 200 kuota të tjera dhe 400 rekrutime të tjera janë planifikuar për gjysmën e dytë të vitit. Sipas ministrit, largimet vullnetare janë ulur me 70%, ndërsa vetëm në janar-shkurt janë rikthyer 48 ushtarakë në radhët e FA-së.

Ka nisur gjithashtu rekrutimi i 363 rezervistëve për këtë vit, ndërsa për herë të parë kontratat do të shoqërohen me bursa, fillimisht për mjekët dhe të rinjtë që ndjekin specializime në mjekësi.

Në vijim, hapen procedurat për përzgjedhjen e 10 kadetëve të parë të Shkollës së Aviacionit nga 40 kandidatë të përzgjedhur fillimisht, të cilët do të ndjekin



një kurrikul 18-mujore për certifikim si pilotë. Dy helikopterë stërvitorë të porositur vitin e kaluar pritet të mbërrijnë së shpejti.

Investime në emergjencat civile

Ministri u ndal edhe te fondi i kushtëzuar për mbrojtjen civile, duke theksuar se për 47 bashki ka pasur rritje të konsiderueshme të financimeve, me shumëfishim fondesh për bashkitë me kapacitete më të kufizuara. Fondi i investimeve për infrastrukturën parandaluese këtë vit arrin në 18 milionë euro, nga të cilat 8 milionë për projekte në vijim dhe 10 milionë për projekte të reja si diga, prita lumore, ura dhe rehabilitime infrastrukturore.

Po ashtu, është në proces prodhimi i mjeteve të reja për emergjencat civile, që do të transferohen bashkive më në nevojë, ndërsa janë në finalizim negociatat për blerjen e dy avionëve zjarrfikës, me synimin që të paktën një të jetë operacional brenda vitit.

Forcat Ajrore synojnë të kenë minimalisht katër helikopterë operacionalë për çdo emergjencë gjatë

këtij sezoni.

Angazhime ndërkombëtare dhe mekanizma rajonale

Vengu theksoi se mekanizmat trelateralë, si marrëveshja Shqipëri-Kosovë-Kroaci, janë praktika të njohura brenda NATO-s dhe do të vijojnë të shfrytëzohen për prokurime të përbashkëta, trajnime apo qëndrime politike të koordinuara.

Gjithashtu, Shqipëria ka shprehur dakordësinë në parim për t'u përfshirë në Forcën Ndërkombëtare të Stabilizimit në Gaza, në kuadër të misionit të Bordit të Paqes, përmes një formule “ombrellë” nën drejtimin e një vendi aleat. Në fazën e parë parashikohet përfshirja me oficerë në shtabin që do të krijohet për këtë qëllim.

Në përmbyllje, ministri bëri të ditur se në fund të marsit Akademia e Forcave të Armatosura do të marrë në përdorim godinën e re, një tjetër investim në funksion të modernizimit dhe rritjes së cilësisë së arsimit ushtarak në vend.





SHSHPFA, Gjenerallejtënant Arben Kingji: Angazhim i palëkundur i FA në misionin e KFOR

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim me Shefin e Shtabit të KFOR-it, Kundëradmiral Maximilian Clark, ku u diskutua mbi situatën e sigurisë në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Gjatë takimit, bashkëbiseduesit vlerësuan rolin e rëndësishëm të misionit të KFOR-it në ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm në Kosovë, si dhe kontributin e vazhdueshëm të vendeve pjesëmarrëse në këtë mision të udhëhequr nga NATO.

Gjenerallejtënant Kingji theksoi angazhimin e palëkundur të Shqipërisë dhe të Forcave të Armatosura në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi në NATO, duke nënvizuar profesionalizmin dhe përkushtimin e efektivëve shqiptarë në misionet ndërkombëtare. Takimi shërbeu gjithashtu për të riafirmuar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe strukturave të KFOR-it, në funksion të forcimit të stabilitetit rajonal dhe sigurisë kolektive.



Kadetët e Akademisë së Forcave të Armatosura dhurojnë gjak, në mision humanitar për jetën

Studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura iu bashkuan nismës për dhurimin vullnetar të gjakut, duke dëshmuar edhe një herë se misioni i tyre nis me shërbimin ndaj jetës dhe komunitetit.

Në kuadër të aktiviteteve me karakter social dhe humanitar, kadetët kontribuan me përgjegjësi dhe përkushtim në këtë akt solidariteti, i cili synon të ndihmojë pacientët në nevojë dhe të mbështesë sistemin shëndetësor në vend.

Me frymë humanizmi dhe ndjenjë të lartë qytetarie, studentët e Akademisë u bënë pjesë e kësaj nisme, duke përcjellë mesazhin se uniforma ushtarake përfaqëson jo vetëm përgatitje profesionale dhe gatishmëri operacionale, por edhe vlera të forta morale e shoqërore.

Përfaqësues të institucionit vlerësuan angazhimin e kadetëve, duke theksuar se aktivitete të tilla forcojnë ndërgjegjësimin për rëndësinë e dhurimit vullnetar të gjakut dhe konsolidojnë lidhjen mes Forcave të Armatosura dhe komunitetit.

Të jesh pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura do të thotë të jesh gjithmonë gati për të shërbyer – në uniformë dhe në çdo rrethanë – por mbi të gjitha si qytetar me integritet, solidaritet dhe ndjenjë përgjegjësie ndaj jetës.



Komandanti i Forcës Tokësore, Gjeneralmajor Petrit Çuni priti Shefin e Shtabit të KFOR-it: Në fokus siguria rajonale dhe angazhimi i Forcës Tokësore

Gjeneral Major Petrit Çuni, Komandant i Forcë Tokësore, zhvilloi një takim pune me Shefin e Shtabit të KFOR-it, Kundëradmiral Maximilian Clark, ku në qendër të diskutimeve ishte roli i misionit të NATO-s në ruajtjen e sigurisë në Kosovë dhe në rajon.

Gjatë takimit u vlerësua kontributi i Forcës Tokësore në operacionet ndërkombëtare, veçanërisht angazhimi i Batalionit të Këmbësorisë



së Lehtë, i cili ka marrë drejtimin e batalionit shumëkombësh që gjeneron Forcën Operacionale të Rezervës (ORF), në kuadër të misioneve KFOR dhe EUFOR Althea.

Bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe strukturave të NATO-s, si një garanci për stabilitetin dhe sigurinë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Takimi u përmbyll me ndjekjen nga afër të rreshtimit të trupave dhe mjeteve të Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, si dhe me një demonstrim të shkurtër të operacioneve të mbështetjes së paqes (OMP), duke evidentuar nivelin e lartë të përgatitjes dhe gatishmërisë operacionale të efektivëve shqiptarë.



Gjenerallejtënant Arben Kingji: KMS drejt transformimit në qendër ekselence për lidërshtipin ushtarak

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një bashkëbisedim me kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit dhe Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, të cilat zhvillohen në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS).

Gjatë fjalës së tij, Gjenerallejtënant Kingji ndau këshilla dhe objektiva konkrete që synojnë rritjen e cilësisë së kurrikulave dhe përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Ai theksoi rëndësinë e integritetit të mësimëve të nxjerra nga përvojat operationale, si dhe nevojën për transformimin e KMS-së në një qendër ekselence për arsimimin dhe kualifikimin e lidërshtipit ushtarak dhe ndërinstitutional.

Në këtë kuadër, u nënvizua se Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s dhe kontribues aktiv në operationet ndërkombëtare, ka përgjegjësinë për përgatitjen e oficerëve të karrierës me standarde të larta profesionale. Sipas tij, oficerët duhet të jenë të aftë për të përmbushur detyra në shtabe, komanda dhe mjedise shumëkombëshe, duke garantuar gatishmëri



të plotë dhe aftësi të avancuara për përballimin e sfidave në një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks. Aktivitete të tilla kontribuojnë drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve profesionale të Forcave të Armatosura dhe në përmbushjen me sukses të angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të vendit.



Batalioni i Xhenios realizon operatione EOD në Elbasan, Delvinë dhe Mirditë, duke garantuar sigurinë e komunitetit

Batalioni i Xhenios në Komandën Mbështetëse ka finalizuar me sukses një seri operationesh të neutralizimit të municioneve shpërthyes (EOD) në bashkitë Elbasan, Delvinë dhe Mirditë. Kryeoperatorët EOD, duke përdorur ekspertizën e tyre të specializuar, kryen fillimisht vlerësimin e municioneve luftarake të identifikuara, për të vijuar më pas me lëvizjen dhe transportimin e tyre në ambientet e sigurta të përcaktuara. Batalioni i Xhenios vazhdon të kontribuojë në garantimin e sigurisë së jetës dhe pronës së komunitetit, duke demonstruar gatishmëri, profesionalizëm dhe përkushtim të lartë në çdo ndërhyrje. Ky aktivitet tregon rëndësinë e operationeve EOD për mbrojtjen e qytetarëve dhe forcimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura.



QKKSH dhe FSHALTM nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për operationet e kërkim-shpëtimit

Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (QKKSH) dhe Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor (FSHALTM) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi që synon forcimin e koordinimit dhe reagimit operational në operationet e kërkim-shpëtimit, veçanërisht në rastet e aksidenteve ajrore në Rajonin e Kërkim-Shpëtimit të Republikës së Shqipërisë.

Kjo marrëveshje përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së kapaciteteve ndërinstitutionale, sidomos në terrene të vështira malore, ku kërkohet ekspertizë e specializuar dhe reagim i shpejtë. Bashkëpunimi synon të garantojë një ndërveprim më efikas ndërmjet strukturave shtetërore dhe organizatave të specializuara në shpëtimin malor.

Angazhimi i përbashkët vjen në përmbushje të detyrimeve të Shqipërisë si shtet anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), si dhe në zbatim të standardeve të përcaktuara në Aneksin 12 "Search and Rescue", që rregullon organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të kërkim-shpëtimit në rastet e emergjencave ajrore. Kryetari i QKKSH-së, Kolonel Fiqiri Hoxha, falënderoi Presidentin e FSHALTM, z. Artur Guni, për gatishmërinë dhe angazhimin në shërbim të shpëtimit



të jetës njerëzore. Ai theksoi se realizimi i trajnimeve të përbashkëta dhe shkëmbimi i përvojave do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit operational dhe në përmirësimin e kapaciteteve reaguese në situata emergjente. Marrëveshja konsolidon më tej rolin e strukturave të kërkim-shpëtimit në vend dhe kontribuon në forcimin e sigurisë ajrore dhe mbrojtjes së jetës njerëzore në territorin e Republikës së Shqipërisë.



Kapiten i Rangut I Arjan Çollaku dhe Kapiten i Rangut II Edion Hoxha emërohen në detyrë

Kundëradmiral Arsen Mullaj vlerëson profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre

Në Komandën e Forcës Detare dhe në Distriktin Detar të Veriut u zhvilluan ceremonitë zyrtare të emërimit në detyrë të Shefit të Shtabit të Forcës Detare, Kapiten i Rangut I Arjan Çollaku, dhe të Komandantit të Distriktit Detar të Veriut, Kapiten i Rangut II Edion Hoxha.

Gjatë ceremonisë, Komandanti i Forcës Detare, Kundëradmiral Arsen Mullaj, vlerësoi përkushtimin, profesionalizmin dhe rezultatet e arritura deri më tani nga efektivët e emëruar. Ai shprehu bindjen se përvoja dhe aftësitë e tyre do të garantojnë realizimin me sukses të detyrave të ngarkuara, si dhe avancimin e projekteve të zhvillimit dhe modernizimit të Forcës Detare. Ceremonitë nënvizuan rëndësinë e vazhdimësisë dhe të përgatitjes së lartë profesionale të personelit,



duke përforcuar rolin e Forcës Detare në ruajtjen e sigurisë dhe interesave të Shqipërisë në ujërat territoriale dhe rajonin e Adriatikut.

Katër vite luftë në Ukrainë: Një plagë e hapur në zemër të Evropës

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Katër vite nga dita kur Rusia nisi pushtimin në shkallë të gjerë ndaj Ukrainës, duke tronditur jo vetëm rendin evropian të sigurisë, por edhe vetë arkitekturën globale të marrëdhënieve ndërkombëtare. Katër vite më pas, kjo luftë nuk është më vetëm një konflikt territorial, ajo është shndërruar në një përballje të zgjatur midis koncepteve të sovranitetit, fuqisë, identitetit kombëtar dhe balancave të reja gjeopolitike.

Ky përvjetor nuk është thjesht një shifër kalendarike. Është një pikë reflektimi për mijëra jetë të humbura, për miliona njerëz të zhvendosur, për qytete të shkatërruara dhe për një kontinent që u zgjua brutalisht nga iluzioni se luftërat e mëdha i përkisnin së kaluarës.

Nga iluzioni i paqes te realiteti i luftës

Kur tanket ruse kaluan kufirin në shkurt të vitit 2022, shumë analistë besonin se bëhej fjalë për një ofensivë të shpejtë, me objektiva të kufizuara dhe një zgjidhje të shpejtë politike. Por rezistenca e ashpër ukrainase dhe mobilizimi i papritur i shoqërisë e ndryshuan trajektoren e konfliktit.

Kievi, që mendohej se do të binte brenda pak ditësh, u shndërrua në simbol të qëndresës. Presidenti Volodymyr Zelenskyy, nga një figurë shpesh e nënvlerësuar para luftës, u kthye në një lider lufte që mobilizoi opinionin publik ndërkombëtar.

Në anën tjetër, Vladimir Putin e paraqiti ndërhyrjen si një operacion “special”, duke synuar të rivendoste ndikimin rus në hapësirën post-sovjetike dhe të pengonte afrimin e Ukrainës me Perëndimin. Por katër vite më pas, ajo që supozohej të ishte një demonstrim force, është kthyer në një konflikt rraskapitës për të dyja palët.

Luftë e përmasave të reja

Kjo luftë ka rikthyer imazhe që Evropa shpresonte se i kishte lënë pas, luftë pozicionesh, front të gjatë, bombardime infrastrukturore dhe qytete të rrënuara. Por njëkohësisht, ajo ka qenë edhe një laborator i luftës moderne.

Dronët, inteligjenca artificiale, satelitët komercialë dhe lufta kibernetike janë bërë pjesë integrale e betejës. Fusha e betejës nuk është vetëm toka, ajo është edhe hapësira informative, ku propaganda dhe dezinformimi janë përdorur si armë po aq të fuqishme sa artileria.

Në këtë kuptim, lufta në Ukrainë ka shënuar një epokë të re: një konflikt ku teknologjia dhe narrativat janë po aq vendimtare sa tanket dhe raketat.

Kostoja njerëzore, përtej statistikave

Shifrat janë tronditëse, por ato nuk arrijnë të përçojnë plotësisht tragjedinë njerëzore. Miliona ukrainas janë detyruar të lënë shtëpitë e tyre. Familje janë ndarë. Fëmijë janë rritur mes sirenave të alarmit dhe strehimoreve nëntokësore.

Historia na mëson se edhe konfliktet më të gjata përfundojnë, shpesh jo me fitore absolute, por me kompromise të dhimbshme. Sfidat do të jetë ndërtimi i një paqeje që nuk është thjesht mungesë e armëve, por një arkitekturë e re sigurie që garanton stabilitet afatgjatë.



Qytete si Mariupol dhe Bakhmut janë kthyer në simbole të shkatërrimit total. Infrastruktura energjetike është goditur vazhdimisht, duke lënë miliona njerëz pa drita e ngrohje gjatë dimrave të ashpër.

Katër vite më pas, trauma kolektive e shoqërisë ukrainase është e thellë. Por po aq e dukshme është edhe vendosmëria për të mos u dorëzuar.

Europa përballë realitetit të ri

Lufta ka detyruar Bashkimin Evropian të rishikojë prioritetet e tij strategjike. Shtete që për dekada kishin ulur shpenzimet ushtarake, nisën riarmatosjen. Debati për sigurinë energjetike u bë qendror, sidomos pas shkëputjes graduale nga gazi rus.

NATO u përball me një rilindje të rolit të saj. Aleanca u zgjerua dhe forcoi praninë në krahun lindor, duke sinjalizuar se lufta në Ukrainë kishte ndryshuar përgjithmonë ekuilibrat e sigurisë në Evropë.

Në të njëjtën kohë, solidariteti me Ukrainën ka qenë një test i unitetit perëndimor. Sanksionet ndaj Rusisë, ndihma ushtarake dhe financiare për Kievin, si dhe menaxhimi i krizës së refugjatëve kanë kërkuar një koordinim të paprecedentë.

Lufta që po riformëson rendin botëror

Konflikti ka thelluar ndarjet midis Perëndimit dhe fuqive të tjera globale. Ai ka nxitur një debat më të gjerë mbi rendin ndërkombëtar, mbi rolin e fuqive të mëdha dhe mbi kufijtë e sovranitetit. Katër vite më pas, bota duket më e fragmentuar. Aleancat janë forcuar, por edhe polarizimi është rritur. Lufta në Ukrainë është bërë një pikë referimi për çdo diskutim mbi sigurinë globale, nga Azia deri në Lindjen e Mesme.



A ka dritë në fund të tunelit?

Pyetja që shtrohet sot, katër vite pas fillimit të luftës, është e thjeshtë dhe e rëndë njëkohësisht: a ka një fund në horizont?

Negociatat kanë qenë sporadike dhe të brishta. Mosbesimi midis palëve është i thellë. Territoret e pushtuara mbeten çështje thelbësore dhe simbolike. Çdo kompromis shihet si rrezik për të ardhmen e shtetit ukrainas apo për prestigjin e Kremlinit.

Megjithatë, historia na mëson se edhe konfliktet më të gjata përfundojnë, shpesh jo me fitore absolute, por me kompromise të dhimbshme. Sfidat do të jetë ndërtimi i një paqeje që nuk është thjesht mungesë e armëve, por një arkitekturë e re sigurie që garanton stabilitet afatgjatë.

Katër vite më pas: çfarë kemi mësuar?

Së pari, se paqja nuk është e dhënë, ajo kërkon investim, vigjilencë dhe angazhim të vazhdueshëm. Së dyti, se sovraniteti dhe integriteti territorial mbeten parime thelbësore të rendit ndërkombëtar. Dhe së treti, se shoqëritë, kur përballen me kërcënime ekzistenciale, mund të mobilizohen në mënyra të jashtëzakonshme.

Katër vite luftë në Ukrainë janë një kujtesë e dhimbshme se Evropa nuk është e imunizuar nga tragjeditë e mëdha. Por ato janë edhe një dëshmi e qëndresës njerëzore.

Në këtë përvjetor, më shumë se sa të numërojmë vitet, duhet të reflektojmë mbi përgjegjësinë kolektive për të mos lejuar që kjo luftë të bëhet “normaliteti i ri”. Sepse normalizimi i dhunës është humbja më e madhe që mund të pësojë një kontinent që ndërtoi identitetin e tij modern mbi premtimin e paqes.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kur paraja fillon të fitojë shumë vlerë në jetë...
viktima e parë është familja...

Ka një moment të padukshëm në jetën e njeriut kur paraja pushon së qeni mjet dhe fillon të bëhet qëllim. Nuk ndodh me zhurmë. Nuk shpallet publikisht. Thjesht, dita zgjatet në zyrë, telefonatat shtohen në darkë, fundjavat mbushen me “angazhime të domosdoshme”. Dhe në heshtje, viktima e parë është familja.

Paraja është e nevojshme. Ajo siguron strehë, ushqim, arsim, kujdes shëndetësor. Ajo jep dinjitet dhe pavarësi. Por kur fillon të fitojë shumë vlerë kur bëhet masa e suksesit, burimi kryesor i vetëvlerësimit dhe kriteri i çdo vendimi, ajo fillon të kërkojë sakrifica. Dhe sakrifica më e shpeshtë është koha me njerëzit tanë.

Koha që nuk kthehet më

Familja nuk kërkon gjithmonë luks. Ajo kërkon prani. Një darkë pa telefon në dorë. Një bisedë pa nxitim. Një fundjavë pa ankthin e email-eve.

Por në kulturën moderne të performancës, puna shpesh glorifikohet si heroizëm. Njeriu që “sakrifikon gjithçka për suksesin” admirohet. Orët e gjata konsiderohen dëshmi ambicieje. Dhe në këtë narrativë, mungesa në shtëpi justifikohet si investim për të ardhmen.

Ironia? Fëmijët nuk rriten me projeksione financiare. Ata rriten me kujtime. Dhe koha e humbur nuk rikthehet me asnjë bonus.

Kur sukseasi bëhet zëvendësim emocional

Shpesh, përkushtimi ekstrem ndaj parasë nuk është vetëm ambicie, është edhe arratisje. Puna bëhet vendi ku ndihemi të kontrolluar, të vlerësuar, të suksesshëm. Ndërsa familja me sfidat, konfliktet dhe përgjegjësitë e saj kërkon durim, ndjeshmëri dhe kohë. Është më e lehtë të mbyllësh një marrëveshje sesa të përballesh me një krizë adoleshente. Më e thjeshtë të ndjekësh një objektiv financiar sesa të ndërtosh komunikim të thellë me partnerin.

Dhe kështu, paraja fillon të zëvendësojë emocionet. Dhuratat zëvendësojnë praninë. Pushimet luksoze zëvendësojnë përditshmërinë e përbashkët. Por asnjë dhuratë nuk kompenson mungesën e përhershme.

Fëmijët dhe modeli i heshtur

Fëmijët nuk dëgjojnë vetëm çfarë u themi; ata shohin çfarë bëjmë. Kur prindi është gjithmonë i zënë, gjithmonë i stresuar, gjithmonë duke ndjekur “diçka më shumë”, mesazhi është i qartë: paraja është prioritet.

Ata mund të përfitojnë komoditete, por humbasin modelin e ekuilibrit. Dhe shpesh, rrethi përsëritet. Brezi tjetër rritet me të njëjtin obsesion për performancë dhe të njëjtin mungesë kohe për lidhje.

Në këtë mënyrë, kostoja e teprimit financiar nuk është vetëm individuale; është ndërbreznore.

Çifti nën presion

Kur paraja bëhet qendra e jetës, marrëdhënia e çiftit shpesh reduktohet në logjistikë: kush paguan çfarë, si investojmë, si rrisim të ardhurat. Bisedat për ëndrra, frikëra dhe ndjenjat zbehen.

Stresi financiar edhe kur buron nga dëshira për më shumë dhe jo nga mungesa krijon tension. Ambicia e njërit mund të perceptohet si mungesë përkushtimi ndaj familjes nga tjetri.

Dhe dalëngadalë, shtëpia kthehet në hotel tranziti, një vend ku fle, por nuk jeton plotësisht.

Iluzioni i “më vonë”

Argumenti më i zakonshëm është: “Po e bëj për familjen”, “Edhe pak vite sakrificë”, “Kur të arrij këtë objektiv, do të kem më shumë kohë”.

Por objektivat zhvendosen. Niveli i jetesës rritet. Standardet ndryshojnë. “Më vonë” bëhet një horizont që largohet vazhdimisht.

Ndërkohë, fëmijët rriten. Prindërit plaken. Momentet e vogla, ato që ndërtojnë lidhjen kalojnë pa u vënë re.

Paraja si mjet, jo si Zot

Problemi nuk është paraja. Problemi është hierarkia e vlerave. Kur paraja bëhet mbi marrëdhëniet, mbi shëndetin, mbi kohën, ajo fillon të kërkojë më shumë sesa jep. Ajo ofron siguri materiale, por mund të varfërojë emocionalisht. Një familje nuk matet me bilanc financiar, por me cilësinë e lidhjes. Me besimin. Me praninë. Me mbështetjen në kohë të vështira.

Paradoksi i pasurisë: Sa më shumë kemi, aq më shumë na mungon

“Pasuria është si uji i detit, sa më shumë pihet, aq më

Paraja, Pushteti dhe Familja: Drama e Heshtur e Prioriteteve të Përmbysura



A kemi ndryshuar ne
paranë... apo paraja
ka ndryshuar ne?

shumë etje të jep”. Kjo thënie e lidhur me filozofin gjerman Arthur Schopenhauer dhe nuk është thjesht një figurë letrare, por është një diagnozë e thellë e shpirtit njerëzor, një vëzhgim i ftohtë mbi mënyrën si funksionon dëshira, ambicia dhe raporti ynë me pasurinë.

Në një epokë ku sukseasi matet me zero në llogari bankare, me metra katrorë, me ndjekës në rrjete sociale dhe me tituj pronësie, paradoksi i pasurisë është më i dukshëm se kurrë. Jetojmë në kohën e bollëkut material, por edhe të mungesës së thellë ekzistenciale.

Dëshira si pus pa fund

Dëshira njerëzore është një mekanizëm i pangopshëm. Ajo nuk synon qetësinë, ajo synon vazhdimësinë. Kur arrijmë atë që duam, kënaqësia është e shkurtër. Euforia e suksesit zgjat pak, pastaj vjen boshllëku. Dhe nga ai boshllëk lind një dëshirë e re.

Pasuria nuk e ngop ambicien, e zgjeron atë. Sapo arrijmë një nivel jetese, ai bëhet standardi ynë i ri. Shtëpia që dikur ishte ëndërr, sot është “normale”. Makina që dikur na dukej luks, sot është e zakonshme. Ne nuk krahasojmë veten me atë që ishim dje, por me atë që kanë të tjerët sot.

Shoqëria e krahasimit të përhershëm

Në epokën digjitale, krahasimi është bërë sport global. Pasuria nuk është më vetëm çështje sigurie apo rehatie; ajo është simbol statusi. Dhe statusi kërkon publik.

Rrjetet sociale kanë krijuar një skenë ku sukseasi ekspozohet, filtrohet dhe amplifikohet. Udhëtimet luksoze, restorantet elitare, ora e shtrenjtë, makina e fundit të gjitha bëhen pjesë e një narrative personale që shpesh synon të bindë të tjerët, por edhe veten.

Por sa më shumë ekspozohet pasuria, aq më shumë rritet presioni për ta ruajtur dhe për ta tejkaluar. Nuk mjafton të jesh mirë, duhet të dukesh më mirë se të tjerët. Dhe kështu, gara nuk ka vijë përfundimi.

Nga mbijetesa te pangopësia

Dëshira për pasuri ka një bazë të arsyeshme, sigurinë.

Njeriu kërkon stabilitet, strehë, ushqim, arsim për fëmijët. Por në një moment, ne kalojmë nga nevoja në akumulim. Këtu lind paradoksi, kur pasuria kalon kufirin e nevojës dhe hyn në territorin e identitetit, ajo bëhet pjesë e vetëvlerësimit tonë. Nuk themi më “kam shumë”; themi “jam i suksesshëm sepse kam shumë”.

Në këtë pikë, humbja e pasurisë nuk është thjesht humbje material, është krizë identiteti.

Kapitalizmi dhe iluzioni i mjaftueshmërisë

Sistemi ekonomik global është ndërtuar mbi rritjen. Rritja kërkon konsum. Konsumi kërkon dëshirë. Dhe dëshira kërkon mungesë. Reklamat nuk na shesin produkte, na shesin ndjesinë se nuk jemi mjaftueshëm të bukur, jo mjaftueshëm të suksesshëm, jo mjaftueshëm të lumtur. Zgjidhja? Një blerje tjetër.

Por çdo blerje prodhon vetëm një kënaqësi të përkohshme. Kështu, pasuria bëhet një horizont që largohet sa herë që i afrohemi.

Elitat dhe ankthi i humbjes

Ironikisht, ata që kanë më shumë shpesh jetojnë me frikën më të madhe, frikën e humbjes. Sa më e madhe pasuria, aq më i madh rreziku për ta ruajtur. Investime, tregje financiare, luhatje ekonomike, pasuria e madhe kërkon vigjilencë të përhershme.

Në vend që të sjellë qetësi, ajo shpesh prodhon ankth. A do të bjerë tregu? A do të ndryshojnë politikat fiskale? A do të humbas avantazhin konkurrues?

Kështu, njeriu që dikur kërkonte pasuri për të qenë i lirë, përfundon i lidhur me të.

Pasuria dhe boshllëku ekzistencial

Shumë figura publike, pasi kanë arritur majat e suksesit financiar, flasin për një boshllëk të papritur. Arritja e gjithçkaje materiale nuk garanton kuptim.

Këtu qëndron thelbi i paradoksit, pasuria mund të blejë rehati, por jo domosdoshmërisht qëllim. Mund të blejë argëtim, por jo domosdoshmërisht paqe të brendshme.

Kur identiteti ndërtohet vetëm mbi suksesin material, çdo krizë ekonomike kthehet në krizë personale.

Pabarazia dhe pasuria si pushtet

Në dimensionin shoqëror, paradoksi i pasurisë merr një ngjyrë tjetër. Në një botë ku një pjesë e madhe e popullsisë lufton për nevojat bazë, grumbullimi ekstrem i pasurisë krijon tension social.

Pasuria nuk është vetëm komoditet, ajo është pushtet. Ajo ndikon në politika, në media, në vendimmarrje. Dhe kur pushteti përqendrohet, demokracia dobësohet.

Në këtë kuptim, paradoksi i pasurisë nuk është vetëm psikologjik, është politik.

A ka një rrugëdalje?

Pyetja thelbësore është a mund të ndërtojmë një raport më të shëndetshëm me pasurinë?

Ndoshta çelësi qëndron në dallimin midis mjetit dhe qëllimit. Pasuria si mjet për dinjitet, arsim, shëndet dhe liri është e arsyeshme. Pasuria si qëllim në vetvete është kurthi. Reduktimi i dëshirës, dhe jo zgjerimi i saj, është rruga drejt qetësisë. Në një shoqëri që predikon zgjerimin e pandërprerë, kjo tingëllon pothuajse revolucionare.

Një reflektim për kohën tonë

Sot, paradoksi i pasurisë shfaqet në çdo dimension, nga individi që punon pa pushim për një promovim, te korporata që synon rritje të pafundme, te shtetet që matin suksesin vetëm me Prodhimin e Brendshëm Bruto.

Por ndoshta matësi më i saktë i një shoqërie nuk është sa prodhon, por sa është e aftë të krijojë kuptim, drejtësi dhe mirëqenie të shpërndarë.

Pasuria është si uji i detit. Mund të duket e pafundme, joshëse, e ndritshme nën diell. Por nëse e pimë pa masë, ajo na lë më të etur se më parë.

Në fund, pyetja nuk është sa kemi, por sa na mjafton. Dhe ndoshta, në një epokë të tepricës, akti më radikal është të thuash: mjaft.

Nga Tirana në Flotën e SHBA-së: Komandant Alban Dervishi, Shqiptari që Ndriçon në Karrierën Ushtarake Amerikane



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Komandant Alban Dervishi është lindur në Tiranë dhe emigroi në Queens, Nju Jork, për të ndjekur 'Ëndrrën Amerikane'. Pas përfundimit të shkollës së mesme, ai u regjistrua në Forcat Detare në vitin 2001 dhe mori gradën 'oficer' në vitin 2009, përmes Shkollës së Kandidatëve për Oficerë (Officer Candidate School).

Komandant Dervishi përfundoi studimet Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare, me nënspecializim në Studime Rajonale Evropiane dhe Aleancën e NATO-s, në Webster University, në bashkëpunim me Army Command and General Staff College.

Përvoja Operacionale

Detyrat e tij operacionale përfshijnë:

- Shërbim në bordin e **USS BATAAN (LHD-5)** në mbështetje të operacioneve **Operation Enduring Freedom** dhe **Operation Iraqi Freedom** (2001–2004).
- Shërbim në bordin e **USS CARTER HALL (LSD-50)** në mbështetje të operacionit **Operation Unified Response** në Haiti dhe operacioneve në zonën e përgjegjësive të Flotës së 5-të (2009–2012).
- Shërbim në bordin e **USS ASHLAND (LSD-48)** në mbështetje të operacioneve në zonën e Flotës së 7-të (2016–2018).
- Shërbim në bordin e **USS MOUNT WHITNEY (LCC-20)** në mbështetje të disa stërvitjeve të NATO-s, Flotës së 2-të dhe Flotës së 6-të të SHBA-së në Detin Baltik, Detin e Zi dhe Detin Mesdhe (2018–2020).

Detyra e tij më e fundit ishte Zëvendëskomandant (Executive Officer) i **USS PEARL HARBOR (LSD-52)**.

Shërbimi në Tokë

Në detyra në tokë, ai ka shërbyer si Zëvendësdyrëtor i Watchfloor në Qendrën e Komandës së Flotës së Gjashtë. Ai ka fituar titullin 'Amphibious Warfare Tactics Instructor' dhe ka shërbyer si oficer N4 në Amphibious Squadron Eight.

Gjithashtu, duke treguar fleksibilitet në strukturat e shtabit, ai mori përkohësisht detyrën e Zëvendëskomandantit të **USS MESA VERDE (LPD-19)**. Ai përfundoi turin e tij të përbashkët në NATO si Oficer Operacionesh në Komandën Detare Italiane, në mbështetje të disa operacioneve shumëkombëshe TRI-CARRIER.

Dekorata dhe Vlerësime

Komandant Dervishi është nderuar me:

- Medaljen e Shërbimit të Merituar në Mbrojtje (Defense Meritorious Service Medal);
- Medaljen e Lavdërimit të Marinës dhe Trupave Detare (5 herë);
- Medaljen e Arritjeve të Marinës dhe Trupave Detare (3 herë);
- Si dhe dekorata të ndryshme njësishe dhe medalje shërbimi/fushate.

Në qershor 2025, Komandant Alban Dervishi mori komandën e **USS PEARL HARBOR (LSD-52)**.

Prejardhja dhe përvoja personale

Komandant Dervishi, si e kujtoni fëmijërinë tuaj në Tiranë dhe çfarë ndikimi patën rrënjët tuaja shqiptare në formimin tuaj si oficer?

Vitet 1990 në Tiranë ishin një shkollë e vërtetë qëndrese. Përballimi i ndërprerjeve të energjisë elektrike, ndërprerjeve të shkollës, një mjedisi me burime të kufizuara dhe kolapsit të plotë të rendit gjatë ngjarjeve të vitit 1997 më mësuan të lulëzoj në kaos dhe të përshtatem kur burimet janë të pakta. Këto sfida bënë më shumë sesa thjesht të formonin karakterin tim; ato farkëtuuan aftësitë drejtuese që përdor çdo ditë si oficer i marinës. Mbi të gjitha, mbështetja të rrethi im familjar gjatë atyre viteve më mësoi se asnjë mision nuk fitohet vetëm një mësim që përket thekshet drejtpërdrejt në kulturën "të gjithë së bashku" të Marinës.

Sa sfidues ishte emigrimi në Shtetet e Bashkuara 25 vite më parë për ju dhe familjen tuaj, dhe me çfarë vështirësish u përballët në ndjekje të "ëndrrës amerikane"?

Emigrimi në New York, 25 vite më parë, ishte një tronditje e thellë kulturore kalimi nga Tirana në një metropol global kërkonte një përshtatje të shpejtë. Viti i parë ishte veçanërisht i vështirë, ndërsa përballesha me barrierën gjuhësore dhe ritmin e vrullshëm të qytetit. Megjithatë, mbështetja e komunitetit shqiptaro-amerikan në Queens ishte thelbësore. Ata ofruan bazën që na nevojitej për të kapërcyer hendekun midis trashëgimisë sonë dhe shtëpisë sonë të re. Ndjekja e "Ëndrrës



Komandant Alban Dervishi

Amerikane" nuk kishte të bënte vetëm me përpjekjen individuale; kishte të bënte me shfrytëzimin e mbështetjes së komunitetit për të kapërcyer pengesat fillestare të identitetit dhe integritetit.

A ka pasur një moment të veçantë apo një person që ndikoi në vendimin tuaj për t'iu bashkuar Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara?

Vendimi im për t'iu bashkuar Marinës u bazua në një kombinim të trashëgimisë familjare dhe admirimit të hershëm. Si babai im ashtu edhe gjyshi im patën shërbyer në ushtrinë shqiptare, ndaj koncepti i shërbimit ishte pjesë e rritjes sime. Për më tepër, ndërsa jetoja ende në Shqipëri, pashë nga afër praninë e forcave të SHBA-së dhe të NATO-s, dhe fillova t'i idealizoja si një forcë superiore profesionistësh që vepronin për të mirën globale. Mbërrita në SHBA duke e ditur tashmë se doja t'i bashkohesha asaj force për të nderuar trashëgiminë ushtarake të familjes sime dhe për të synuar standardet elitare të ekselencës që përfaqësojnë Shtetet e Bashkuara.

Karriera Ushtarake dhe Përvoja Profesionale

Ju iu bashkuat ushtrisë amerikane menjëherë pas mbërritjes në SHBA. Si ishte ajo periudhë dhe sa e vështirë ishte të përshtateshit me strukturën ushtarake të një force të huaj?

Periudha fillestare ishte jashtëzakonisht kërkuese. Po përballesha me një sfidë të dyfishtë: të zotëroja gjuhën angleze ndërsa njëkohësisht mësoja "gjuhën" e specializuar të Marinës Amerikane. Megjithatë, detyrimi i vendosur për shërbim ofroi një përfshirje 24/7 që përshpejtoi përshtatjen time. Nuk kisha zgjedhje tjetër veçse të përshtatesha shpejt. Zbulova se struktura dhe disiplina e Marinës vepronin si një stabilizues i rëndësishëm; megjithëse kultura ishte e re, pritshmëritë e qarta dhe standardet profesionale ofruan një kornizë që më ndihmoi të integrohesha në jetën amerikane shumë më shpejt se sa do të mundesha në një mjedis civil.

Gjatë viteve, keni marrë pjesë në disa nga operacionet

më të rëndësishme të SHBA-së. Cili nga këto misione pati ndikimin më të madh personal dhe profesional tek ju?

Misioni që pati ndikimin më të madh tek unë ndodhi më 11 shtator 2001. Në moshën vetëm 19-vjeçare, isha caktuar në USS Bataan (LHD 5) në Virginia kur ndodhën sulmet. Të dy prindërit e mi po punonin në Manhattan në atë kohë; misioni u bë menjëherë personal teksa prisja lajme për sigurinë e tyre. Brenda katër orësh u nisëm dhe herët në mëngjesin e nesërm ishim pranë bregut të New York City, të gatshëm për të ofruar ndihmë mjekësore. Pasi prania jonë nuk duhej më aty, lundruam gjysmën e botës për të treguar fuqinë mbi Afganistan. Në ato pak ditë, u rrita shumë shpejt; kuptova misionin dhe qëllimin e vërtetë të shërbimit tim. Nuk ishte thjesht një punë ishte një domosdoshmëri personale dhe kombëtare.

Si do të vlerësonit përvojën tuaj në Operacionet "ENDURING FREEDOM" dhe "IRAQI FREEDOM", gjatë një periudhe kaq kritike të historisë bashkëkohore?

Unë e vlerësoj përvojën time në Operacionet "ENDURING FREEDOM" (Liri e Qëndrueshme) dhe "IRAQI FREEDOM" (Liri në Irak) si furrën ku u formësua identiteti im profesional. Shërbimi gjatë një periudhe kaq kritike më mësoi se Marina nuk ka të bëjë vetëm me anijet dhe teknologjinë, por me qëndrueshmërinë operacionale dhe elementin njerëzor të luftës. Profesionalisht, ishte një shkollë e thellë në logjistikë dhe precizion; personalisht, forcoi "idealin" që kisha si i ri në Shqipëri — se Marina Amerikane është një forcë stabilizuese e aftë për prezencë të qëndrueshme globale. Këto operacione më mësuan se udhëheqja kërkon fokus të qartë në mision, ndërkohë që ruan mirëqenien e Marinës që e zbatojnë atë në kushtet më sfiduese. Ato më transformuan nga një marinar 19-vjeçar i përqendruar te "si" të kryej detyrat, në një oficer të ardhshëm që kupton "pse" dominimi ynë detar është thelbësor për sigurinë globale.

Ju keni shërbyer në Flotën e 6-të Amerikane dhe atë të



7-të, në zona strategjike si Deti Baltik, Deti i Zi dhe Mesdheu. Çfarë mund të na thoni për rëndësinë operacionale të këtyre rajoneve?

Kam pasur gjithmonë një lidhje të veçantë me Europën, gjë që duket qartë në rrugën time profesionale, pasi jam rikthyer në Flotën e 6-të Amerikane disa herë. Ka një kënaqësi të thellë profesionale dhe personale në veprimtarinë në Mesdhe dhe në Detin Baltik. Për mua, këto nuk janë thjesht linja strategjike në një hartë; ato përfaqësojnë një rajon që e kuptoj thellësisht. Profesionalisht, e shoh shërbimin tim të përsëritur në këto rajone si një angazhim për forcimin e sigurisë transatlantike dhe për çuarjen para të interesave tona kombëtare përmes një pranie të qëndrueshme detare. Për mua, veprimtaria në Mesdhe nuk është thjesht të jesh aty; është ndjekja aktive e ndërveprueshmërisë me aleatët tanë të NATO-s dhe mbrojtja e palëkundur e njyave kritike detare. Besoj se duke ruajtur një forcë detare të besueshme dhe të dukshme, ne jemi rojet kryesore të sovranitetit të partnerëve tanë dhe të stabilitetit të vazhdueshëm të teatrit evropian.

Roli i Ri si Komandant i “USS Pearl Harbor”

Çfarë do të thotë për ju personalisht dhe profesionalisht marrja e komandës së “USS Pearl Harbor”

Personalisht, marrja e komandës së “USS Pearl Harbor” (LSD 52) është vlerësimi maksimal i “Ëndrrës Amerikane”. Të kalosh nga një adoleshent që mbërrin në qytetin e New York-ut nga Tirana, në komandimin e një anije lufte të Shteteve të Bashkuara është një dëshmi e mundësive pa kufij të këtij vendi. Profesionalisht, udhëheqja e një anijeje me një emër kaq historik ka një peshë të thellë. “Pearl Harbor” është një emër sinonim i qëndrueshmërisë amerikane dhe vendosmërisë për të kapërcyer vështirësitë. E shoh si detyrën time më të lartë të siguroj që ekuipazhi im të mishërojë të njëjtin shpirt gatishmërie dhe këmbënguljeje, duke nderuar trashëgiminë e atyre që shërbyen para nesh dhe duke qëndruar të gatshëm për çdo sfidë moderne.

Cilat janë prioritetet tuaja ndërsa merrni komandën e një anije lufte kaq të rëndësishme të Marinës Amerikane?

Pas shtatë muajsh në komandë dhe shpërndarjes në të gjithë Paqësorin, prioriteti im kryesor ka qenë ruajtja e një niveli të lartë gatishmërie për misionin, ndërsa forcoj rezistencën



e jashtëzakonshme të ekuipazhit tim. Kam qenë dëshmitar i performancës së tyre në çdo rast, dhe nuk mund të jem më krenar për punën e tyre. Një moment i veçantë i kësaj komande ka qenë misioni ynë humanitar gjatë “Pacific Partnership 2025”, ku demonструam anën e mëshirshme të fuqisë detare amerikane. Megjithatë, ne kurrë nuk humbasim nga syri qëllimin tonë kryesor: të ruajmë gatishmërinë më të lartë, duke siguruar që “USS Pearl Harbor” të qëndrojë si një simbol i dukshëm i forcës amerikane, i gatshëm për t’u përgjigjur çdo sfide në teatrin e Paqësorit.

Nga roli i Zëvendës Komandantit në atë të Komandantit – cilat janë ndryshimet më të mëdha në përgjegjësi dhe marrje vendimesh?

Komanda në det është një përvojë unike, që ndryshon plotësisht perspektivën tuaj mbi udhëheqjen. Kalimi në rolin e Oficerit Komandues përcaktohet nga një ndjesi e thellë dhe e pakthyeshme e përgjegjësisë përfundimtare. Ka momente në mes të Paqësorit, nën yje, kur shikon pajisjet elektronike dhe kupton se nuk ka asnjë jetë tjetër njerëzore ose tokë për 600–700 milje detare në çdo drejtim. Në atë hapësirë të pafund, siguria e mbi 500 marinarëve varet plotësisht mbi supet tuaja. Përtej kësaj peshe, ekziston një ndjesi e thellë e pasjes së një qëllimi në kryerjen e misionit, ndërsa këshillin gjeneratën e ardhshme. Të shohësh marinarët e rinj që ndodhen pikërisht aty, ku isha unë 25 vite më parë, të rriten në udhëheqës të qëndrueshëm dhe luftëtarë profesionistë është ndoshta pjesa më shpërblyese e të qenit në “karrigen qendrore”.

Çfarë sfidash kryesore prisni të përballeni gjatë komandimit të “USS Pearl Harbor” në këtë periudhë të re të tensioneve globale?

Komandimi i “USS Pearl Harbor” në Indo-Paqësor përfshin menaxhimin e një mjedisi kompleks sigurie, të fokusuar në interesat kombëtare detare. Sfidat kryesore është krijimi i një mbrojtjeje të qëndrueshme dhe të besueshme përgjatë “First Island Chain” – (Zinxhirin e parë të ishujve, arkipelagëve të mëdhenj të Paqësorit që dalin nga bregu kontinental i Azisë Lindore), përballë presionit të vazhdueshëm ushtarak. Balancimi i misioneve humanitare me gatishmërinë për betejë shihet si një strategji e dyfishtë; misionet si “Pacific Partnership 2025” ndërtojnë kapacitetet dhe përgatitën për krizë, ndërsa “USS Pearl Harbor” duhet të mbetet një platformë e aftë për veprime luftarake.

Arsimimi dhe Kualifikimi Akademik

Ju keni përfunduar studime të avancuara në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe NATO. Si ju ka ndihmuar kjo bazë akademike në detyrat tuaja ushtarake?

Përvoja ime akademike vepron si një lente strategjike përmes së cilës unë shoh operacionet taktike. Studimi për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe NATO më kanë dhënë një kuptim më të thellë të “pse”-së pas pranisë sonë në ujërat e kontestuara. Më lejon të parashikoj valët gjeopolitike të lëvizjeve tona dhe të komunikoj më mirë rëndësinë e misionit tonë tek ekuipazhi im.

Në Marinë, ne nuk operojmë në zbrazëti; çdo manovër është një mesazh diplomacie dhe parandalimi. Studimet e mia më ndihmojnë të siguroj që “USS Pearl Harbor” të mbetet një instrument i saktë i politikës kombëtare.

Sa e rëndësishme është për një oficer të Marinës të ketë një bazë të fortë akademike, përveç përvojës praktike në terren?

Në Marinën moderne, përvoja dhe rigoroziteti akademik janë të pandashëm. Është një kërkesë profesionale që çdo Oficer Komandues të ketë një diplomë Masteri, sepse kompleksiteti i misionit tonë kërkon më shumë se thjesht aftësi taktike. Një bazë e fortë akademike është thelbësore për të menduar strategjikisht dhe për angazhimin diplomatik që kërkohej kur veprojmë pranë marinave të huaja në ujëra ndërkombëtare. Qoftë për të kuptuar nuancat e ligjit detar, qoftë për të menaxhuar sistemet teknike të sofistikuara të një anijeje lufte moderne, arsimi ynë siguron që mund të përpunojmë informacion kompleks dhe të marrim vendime të duhura nën presion. Për mua, studimet kanë qenë “timoni” intelektual që më lejon të navigoj sfidat gjeopolitike dhe teknike të komandës me saktësi.

Shqipëria, Identiteti dhe Lidhja me Atdheun

Si e ruani lidhjen tuaj me Shqipërinë, ndërsa shërbeni në nivele të larta në ushtrinë amerikane?

Ruajtja e lidhjes me rrënjët e mia është një prioritet natyral si për mua, ashtu edhe për gruan time, pasi të dy jemi rritur

në Shqipëri. Si shumë të tjerë në diasporë, pushimet tona na çojnë instinktivisht sërish në atdhe. Kurrë nuk duket se kemi mjaftueshëm kohë; gjithmonë largohemi duke dëshiruar më shumë. Megjithatë, ato vizita janë thelbësore për t’u rikthyer tek familja dhe miqtë dhe për të siguruar që fëmijët tanë — të lindur në Amerikë — të mbeten të lidhur me trashëgiminë e tyre. Të shohësh që ata presin me padurim çdo udhëtim në Shqipëri është një burim krenarie të madhe. Edhe duke shërbyer në nivele të larta në ushtrinë amerikane, ato vizita më kujtojnë se identiteti im si oficer amerikan forcohet nga vlerat dhe historia e rritjes sime në Shqipëri.

Si e vlerësoni imazhin e shqiptarëve në ushtrinë amerikane dhe kontributin e komunitetit shqiptaro-amerikan në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve?

Komuniteti shqiptaro-amerikan vepron si një “urë e gjallë” thelbësore midis dy vendeve tona. Duke shërbyer në nivele të larta në Forcat e Armatosura të SHBA-së, ne forcojmë besimin që ekziston midis SHBA-së dhe Shqipërisë, si një aleat i qëndrueshëm i NATO-s. Kontributi ynë nuk qëndron vetëm në punën tonë, por edhe në aftësinë për të përkthyer vlerat e të dy kulturave në një mision të përbashkët për stabilitet global. Ky identitet i dyfishtë unik na lejon të jemi disa nga avokatët më pasionantë për forcimin e vazhdueshëm të lidhjes transatlantike.

A keni një mesazh për të rinjtë shqiptarë që ëndërrojnë një karrierë në forcat e armatosura ose në diplomaci?

Mesazhi im për të rinjtë shqiptarë është i thjeshtë: Në forcat e armatosura, do të gjeni mundësi të pakufizuara, por çdo pozicion udhëheqës duhet të fitohet përmes punës së palodhur dhe përkushtimit. Ju mund të jeni të sigurt se do të gjeni një organizatë vërtet bazuar në merita — një që vlerëson performancën mbi çdo gjë tjetër. Nuk ka rëndësi nga ku keni nisur; ajo që ka rëndësi është disiplinimi juaj dhe përkushtimi ndaj misionit. Përdorni qëndrueshmërinë e trashëgimisë suaj si karburant. Nëse jeni të gatshëm të punoni me përkushtim dhe të ruani integritetin tuaj, ky profesion do t’ju ofrojë një rrugë drejt suksesit që bazohet tërësisht në cilësinë e karakterit tuaj dhe rezultatet që arrini.

Çmimet dhe Nderimet

Ju jeni vlerësuar me Medaljen e Shërbimit të Merituar në Mbrojtje dhe disa medalje të tjera të rëndësishme. Çfarë domethënie kanë këto nderime për ju?

I shoh medaljet e mia si një portal; kur i shoh, më kthejnë në momente specifike sakrifice dhe përkushtimi, si të miat ashtu edhe të marinarëve që kam udhëhequr. Ato nuk janë thjesht dekorime, por kujtesa të dislokimeve të gjata dhe vështirësive të përbashkëta që kemi duruar për të përfunduar misionin. Çdo nderim është një dritare në vendosmërinë kolektive të një ekuipazhi që punon drejt një qëllimi të përbashkët. Në fund të fundit, këto çmime përfaqësojnë momentet kur angazhimi ynë ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj kombit u vu në provë dhe ne fituam.

A ka patur ndonjë moment kur ndiet se të gjitha sakrificat tuaja ishin shpërblyer vërtet?

Vite më parë arrita në një pikë ku u ndjeva vërtet i shpërblyer dhe i realizuar në udhëtimin tim. Sot, pasi kam realizuar qëllimet e mia profesionale, fokusi im është zhvendosur tërësisht drejt një misioni të ri: detyrimit për të mbështetur brezin e ardhshëm të luftëtarëve. Shpërblimi më i madh që gjej tani është të sigurohem që të rinjtë dhe të rejtat që vijnë pas meje të kenë të njëjtat - ose më të mira - mundësi sesa unë.

Perspektiva Strategjike

Si e shihni zhvillimin e rolit të Marinës Amerikane në kontekstin e sfidave të sigurisë globale të sotme?

Në mjedisin aktual të sigurisë globale, unë e shoh rolin e Marinës Amerikane përmes këndvështrimit të “Pages përmes forcës”. Siç e ka theksuar lidershipi ynë, ne jemi në një periudhë konkurrence strategjike, ku dominimi detar nuk është vetëm një preferencë, por një domosdoshmëri për stabilitetin global. Ne ruajmë gatishmërinë luftarake të nevojshme për parandalim. Ne veprojmë përpara në mënyrë që të mund të parandalojmë konfliktin para se të fillojë, por mbetemi të përgatitur për të luftuar dhe për të fituar nëse interesat tona kombëtare ose aleatët tanë kërcënohen. Në fund të fundit, Marina është themeli i sigurisë globale, duke siguruar mjedisin e qëndrueshëm të nevojshëm për lulëzimin e diplomacisë dhe prosperitetit ekonomik.

Sa i rëndësishëm është bashkëpunimi i SHBA-së me NATO-n në operacionet detare dhe cilat janë sfidat më urgjente për aleancën?

Bashkëpunimi i SHBA-së me NATO-n është themeli i strategjisë sonë detare; e shoh Aleancën jo vetëm si një partneritet, por si shumëfishuesin tonë më të madh strategjik të forcës. Në përputhje me misionin e Flotës së 6-të Amerikane, fuqia jonë buron nga aftësia për të operuar si një forcë e bashkuar, shumëkombëshe. Megjithatë, Aleanca është më e fortë kur të gjithë Aleatët e saj janë të fortë individualisht. Sfidat më urgjente me të cilën përballemi është përmbushja e angazhimeve për shpenzimet e mbrojtjes dhe operacionalizimi i tyre për të siguruar ndërveprueshmëri të qetë aftësinë e vendeve të ndryshme për të komunikuar, ndarë të dhëna dhe për të kryer manovra komplekse si një njësi e vetme.

Cilat janë qëllimet tuaja afatgjata për karrierën tuaj ushtarake pas komandimit të anijes “USS Pearl Harbor”?
Çfarë këshille do t’u jepnit emigrantëve që kërkojnë sukses në një vend të ri, siç keni bërë ju?

Pas kohës sime në “USS Pearl Harbor”, qëllimi im është të kaloj në një rol të lartë si staf, duke u rikthyer specifikisht në Flotën e 6-të të Shteteve të Bashkuara, për të marrë një rol kyç në planifikimin e operacioneve detare në Europë dhe Afrikë. Kjo do të më lejojë të aplikoj përvojën time operacionale në sfidat më të gjera strategjike të rajonit. Më pas, do të synoj Komandën Madhore, me ambicien për të udhëhequr një anije amfibe me kuvertë të madhe, duke komanduar mijëra marinarë dhe një flotë të integruar ajrore.

Këshilla ime për emigrantët që kërkojnë sukses në një vend të ri është e thjeshtë: Përqafoni sfidën e integritetit pa humbur esencën e identitetit tuaj. Kërkonti organizatë që vlerësojnë meritën dhe performancën, si Marina e Shteteve të Bashkuara, dhe punoni më shumë se të gjithë rreth jush. Suksesi në një vend të ri nuk jepet; fitohet përmes këmbënguljes, përkushtimit ndaj të mësuarit të vazhdueshëm dhe respektit të thellë për vlerat e shtëpisë së re.



MAJOR® MSC. AGRON BUKAÇI*

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i dhanë mbështetje Shqipërisë duke penguar ndarjen e territoreve të saj në përfundim të Luftës së Parë Botërore. Në Konferencën e Paqes në Paris, 1919, Presidenti Woodrow Wilson kundërshtoi planin për copëtimin e Shqipërisë, duke siguruar që vendi të mbetej i pavarur. Ky akt e vendosi atë në kujtesën historike të shqiptarëve si një mbrojtës i sovranitetit të tyre duke u bërë themel i një miqësie të gjatë mes dy vendeve. Mbështetja amerikane për Shqipërinë ka qenë e vazhdueshme dhe e shumëdimensionuar.

Në vitet 1918-1920 qeveria e SHBA-ve jo vetëm e kanë mbrojtur Shqipërinë nga copëtimi i territoreve por kanë patur edhe plane të tjera, ata kanë përfshirë në projektet dhe analizat e tyre edhe përcaktimin e saktë të kufijve me qëllim që të bashkoheshin aq sa është e mundur të gjithë Shqiptarët që jetonin kudo rreth trungut natyror, me qëllimin final realizimin e një shteti të unifikuar “The prospect for the United Albania”.

Aq qartë janë hedhur këto në letër sa që edhe sot e kanë ruajtur vlerën (The new world), madje formulime e fjali të tëra të përdorura 100 vite më parë vazhdojnë të përdoren nga politikanë amerikan si qëndrime konstante serioze të politikës së tyre sa i përket raporteve mes SHB-ve dhe Shqipërisë dhe Shqipërisë me vendet fqinje të sajë.

Po si ndodhi që krerët e shtetit më të madh të botës të interesoheshin për një popull me më pak se 1 milion banorë, por që në fakt me një histori domethënëse nga pellazgët, ilirët dhe më vonë me kohën e Skënderbeut, kishte kapërcyer kufijtë ballkanikë dhe europianë.


Çfarë gjurmësh janë lënë pas në dokumentacionin historik për të shpjeguar afeksionin e habitshëm për Shqipërinë dhe Shqiptarët?

Më shumë se një shekull më parë, në vitet e Luftës së Parë Botërore, shteti i brishtë shqiptar edhe pse me kufij të përcaktuar që në vitin 1913 rrezikonte sërish ndarjen dhe shpërbërjen për të kënaqur synimet historike agresive të shteteve fqinje.

Hapin e parë e hedh Car Nikolla II i Rusisë, i cili në fillimin e LIB planifikon ndarjen e Shqipërisë mes Serbisë, Italisë dhe Greqisë. Në prill të vitit 1915 idetë e Car Nikollës II të Rusisë hidhen në letër në një takim të fshehtë që njihet si “Traktati i fshehtë i Londrës”. Me qëllim për të tërhequr Italinë në anën e tyre britanikët, francezët dhe rusët i premtojnë një numër territorësh të Sllovenisë mes të cilave edhe Vlorën dhe ishullin e Sazanit në Shqipëri.

Harta e Shqipërisë, sipas këtij traktati të fshehtë, është bërë publike për herë të parë në gazetën Ruse “Izvestia”.

Fuqitë e mëdha të Europës kishin planifikuar krijimin e një shteti islamik shqiptar, marrëdhëniet me jashtë të të cilit do të drejtoheshin nga Italia. Vloja dhe rrethinat si dhe ishulli i Sazanit i aneksoheshin Italisë, Korça, Gjirokastra dhe territore të tjera të Shqipërisë së jugut i jepeshin Greqisë. Veriu i Shqipërisë i aneksoheshin Serbisë dhe Malit të Zi edhe krahina e Matit dhe e Dibrës ishin planifikuar t'i jepeshin Serbisë.



Traktati I Fshehtë i Londrës

Justin Godart një politikan dhe shtetar francez i përkushtuar pas të drejtës dhe popujve të shtypur ka përkushtuar në librin “Shqipëria në vitin 1921” të gjitha ndërhyrjet e Presidentit Amerikan Woodrow Wilson në favor të garantimit të kufijve të Shqipërisë herë me fraza e gjuhë diplomatike e herë me gjuhën e vetos apo forcës së një superfuqie. Ai ia ka dalë në krye të ruajtje dhe të garantojë paprekshmërinë e kufijve të shtetit shqiptar të vitit 1913.

Sipas Justin Godart, Presidenti Amerikan Woodrow Wilson u deklarua kundër traktateve të fshehta duke i konsideruar ato si të pa qëndrueshme. Në vijim të të njëjtit qëndrim, më 6 mars 1919, përmbajtja e një letre të shkruar nga Presidenti Woodrow Wilson dërguar Lord Xhorxhit dhe Aleksandër Millonardit, përfaqësuesve të Britanisë së Madhe dhe Francës



Justin GODART

Amerika dhe Presidenti Woodrow Wilson, mbështetja vendimtare për Shqipërinë



Presidenti Woodrow WILSON

në Konferencën e Paqes, shkakton furtunë.

Presidenti Amerikan Woodrow Wilson kundërshtoi dhënien e pikave të mbështetjes në lindje të Adriatikut - Italisë me pretekstin se ky veprim ishte për t'i lejuar asaj sigurimin e brigjeve kundër një agresioni detar nga Austro-Hungaria, kërcënim që nuk ekzistonte më.

Pas dëgjimit të këtij qëndrimi të Presidentit Amerikan Woodrow Wilson përfaqësuesi i Italisë Vittorio Orlando tërhiqet në mënyrë demonstrative nga Konferenca e Paqes; por me gjithë qëndrimin e prerë Amerikan, italianët nuk tërhiqen nga qëllimi i tyre, më 29 korrik 1919, italianët nënshkruan një pakt sekret me grekët, e njohur si marrëveshja Pitoni-Venizellos, ku planifikonin sërish ndarjen e territoreve shqiptare. Përgjigja e Presidentit Amerikan Woodrow Wilson ishte e prerë dhe e vrazhdë: “Këto kushte dhe të tjera akoma nga memorandum i 14 janarit të biseduara pa pëlqimin dhe pa dijeninë e qeverisë amerikane, ndryshojnë plotësisht pikëpamjen e rregullimit të çështjes së Adriatikut, ne nuk mund të japim miratimin tonë në një rregullim, i cili si në termat e klauzolës së tij ashtu edhe në metodat e përdorura për t'u imponuar, përbën një mohim absolut të parimeve për të cilat Amerika hyri në luftë”. Në fund Presidenti Amerikan Woodrow Wilson deklaroi: “Nuk jam i gatshëm të njoh asnjë zgjidhje të padrejtë të fituar duke u përdorur ky traktat sekret (marrëveshja Pitoni-Venizellos) kushtet e të cilit janë të papajtuueshme me situatën e re të botës dhe me asnjë rregullim të padrejtë të fituar duke u përdorur ky traktat sekret si instrument shtrëngimi”.

Edhe pas këtij deklarimi dhe qëndrimi konsekuent të Presidentit Woodrow Wilson përfaqësuesit e Europës nuk tërhiqen, ata formuluan një propozim të ri me justifikimin se serbët do të ndërtonin në Shqipëri me garantimin e ndërkombëtarëve një hekurudhë dhe një port që do t'i siguronte transport të rregullt pjesës jugore të Serbisë. Kjo rrëmujë zgjati deri në një ndërhyrje të fundit të Presidentit Amerikan Woodrow Wilson, i cili bëri publik një qëndrim të qartë dhe të prerë në favor të Shqipërisë dhe Shqiptarëve. “Çështjet shqiptare nuk duhet të bashkohen në diskutimin e propozuar ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë”, dhe Presidenti Amerikan Woodrow Wilson do t'i duhej edhe një herë akoma të deklarojë: “Se nuk do të aprovohet asnjë plan që do t'i caktojë Jugosllavisë një kompensim territorial në pjesën veriore të

Shqipërisë”.

Ky qëndrim i Presidentit Amerikan Woodrow Wilson i preu gishtat edhe përpjekjes së fundit të fqinjëve tanë për të shkëputur territore shqiptare me ndërmjetësimin e fuqive europiane fituese të LIB.

Kjo ishte një betejë e gjatë e durueshme parimore diplomatike por dukej edhe betejë force e fituar nga Presidenti Amerikan Woodrow Wilson në favor të një populli të vogël që ende nuk kishin arritur të faktorizoheshin politikisht apo diplomatikisht, kjo qoftë edhe përmes ndërtimit të një shteti.

Po si mund të shpjegohet gjithë ky angazhim i gjatë i pandryshuar i durueshëm amerikan për Shqiptarët, në një kohë që Presidenti Amerikan Woodrow Wilson ishte i angazhuar me zgjidhjen e çështjeve të dhjetëra kombeve të vegjël që kishin po aq probleme me vetëvendosjen sa edhe Shqiptarët?

Duhet pranuar që ne shqiptarët patëm fat që gjatë zhvillimit të Konferencës së Paqes në Paris zoti Woodrow Wilson kishte atributet e Presidentit të SHBA-ve, ai ishte kreu i një shteti të fuqishëm në botë, ku përfshirja e tij në LIB ndikoi shumë në fitoren e shteteve të Antantës kundër ushtrive gjermane dhe austro-hungareze, ishte koha kur SHBA-të do të riktheheshin fuqishëm sepse prej dhjetëra vitesh SHBA-ja kishte adoptuar atë që quhej: “Politika e izolimit të shkëlqyer”.

Një personalitet si Presidenti Woodrow Wilson arriti ta kthejë Amerikën si faktor vendimtar në politikën globale. SHBA-të u panë si shpëtimtarë të cilët ndikuan në përfundimin e LIB, e cila solli shkatërime si dhe 8 milionë viktima. U propagandua se si Presidenti Amerikan Woodrow Wilson erdhi në Konferencën e Paqes në Paris me një pamflet prej 14 pikash, të cilat tentonin dhe synonin t'i jepnin fund konflikteve europiane si dhe u mor vendimi për krijimin e Lidhjes së Kombeve dhe më vonë OKB.

Paraqitja nga Presidenti Amerikan Woodrow Wilson e një dokumenti prej 14 pikash me qëllim që të shpalosnin synimet e tij jo vetëm si President i SHBA-së por para së gjithash si një vizionar, përbënin një nga zhvillimet më interesante të shoqërisë njerëzore. Dokumenti prej 14 pikash i paraqitur nga Presidenti Amerikan Woodrow Wilson rregullonte problematikat e mëdha të kufijve ndërshtetëror në Europë, Azi e gjetkë dhe sidomos siguronin vetëvendosjen e popujve të vegjël, njëra nga pikat, ajo me numër 11 flet ekskluzivisht për politikën Amerikane në Ballkan, konkretisht: “Rumania, Serbia dhe Mali i Zi duhet të tërhiqen, territorit e pushtuara duhet të rikthehen, kështu Serbisë i sigurohet akses i lirë në det. Marrëdhëniet e një numri shtetesh të Ballkanit të përcaktohen nga këshilltar miqësor përgjatë linjave të vendosura historikisht të besimit dhe kombësisë dhe garancitë ndërkombëtare të pavarësisë politike, ekonomike dhe integritetit territorial”.

Qëndrimi i Presidentit Amerikan Woodrow Wilson përkundrej Shqipërisë në një nga momentet më të vështira dhe më vendimtare e delikate të historisë së Kombit Shqiptar nuk prirej nga ndjenja individuale e Presidenti Amerikan Woodrow Wilson përkundrej Shqipërisë dhe shqiptarëve por prirej nga filozofia e Tij nga formimi i Tij nga karakteri i Tij si një njeri që e donte lirinë e donte demokracinë dhe që ishte i prirur ndaj një bote të zhvilluar harmonike, ku të mos dominonin problemet në marrëdhëniet ndërmjet popujve e midis shteteve. Këto parime i zbatoi në rastin e Shqipërisë, sepse ai u bë dëshmitar që Shqipëria në Konferencën e Paqes në Paris po trajtohej si një plaçkë tregu ku ishte vënë në tryezën e diplomacive të disa shteteve Europiane dhe fqinjëve ku secili kërkonte të merrte çfarë të mundte.

Presidenti Amerikan Woodrow Wilson vuri re një gjë të tillë dhe kërkoi të informohej mbi të vërtetën, sepse në mjediset ku zhvillohej Konferenca e Paqes përhapeshin opinione të gabuara, ku thuhej se është dëshira e vetë shqiptarëve që të bashkoheshin një pjesë me Serbinë dhe një pjesë me Malin e Zi, sepse nuk e ndienin veten komod, duke qëndruar në suazën e një shteti të tyre të pavarur.


Lind pyetja, kush ia solli në vëmendje Presidentit Amerikan Woodrow Wilson çështjen shqiptare, ndërkohë që përballej me problem të brendshme dhe probleme të tjera ndërkombëtare dhe në vendime të tilla ku pleksen interesa të fuqive të mëdha me intensitet të lartë politik, ushtarak dhe ekonomik të qëndrojnë fort tek çështja shqiptare.

Dihet se Presidenti ka staf dhe pjesën më të madhe të problemeve i konsultonte dhe informohej nga stafi i Tij.

Në rastin e çështjes Shqiptare, Presidenti Amerikan Woodrow Wilson i është referuar një informacioni të gjerë dhe interesant që vinte prej përfaqësuesve të Shtetit Amerikan njëri prej të cilëve ishte **George Fred WILLIAM**, i cili kishte qenë ambasador i SHBA-ve në Greqi, në Malin e Zi dhe që mbulonte edhe Shqipërinë.

Në vitin 1915 ambasadori Williams, një personalitet i jashtëzakonshëm nga pikëpamja intelektuale, kulturore e shpirtërore dhe integritet të papërkulur nga ato çfarë ndodhin përreth tij, u bë dëshmitar okular i disa zhvillimeve rrëqethëse dhe të tmerrshme, ai pa me sytë e vet se çfarë po bënin grekët ndaj popullit Shqiptar.





Periodha e zhvillimit të Konferencës së Paqes në Paris ishte periudha më tragjike për shqiptarët, grekët kanë shpërngulur me dhunë popullsinë dhe kanë bërë masakra në krahinat jugore të Shqipërisë, ambasadori Williams në materialin që i dërgoi Departamentit të Shtetit të SHBA-ve në atë kohë, e përshkruan kështu situatën në jugun e Shqipërisë: “Mbi 100 mijë Shqiptarë të shpërngulur me dhunë, grekët i kanë marrë përpara, pleq, gra, fëmijë madje dhe foshnja dhe po i përzhënë në drejtim të Vlorës, ku 30 mijë prej tyre kanë vdekur nga uria dhe epidemi, të gjitha të mbjellat janë shkatërruar, ky është një fat tragjik që nuk mund ta përshkruaj”.

Për shkak të këtij tragjizmi dhe ngurrimit për të mos vepruar për ta ndaluar këtë situatë, ambasadori Williams jep dorëheqjen si ambasador i SHBA-ve në Greqi, është i pari dhe i vetmi ambasador që jep dorëheqjen. Pasi ka dhënë dorëheqjen Ambasadori Williams shkruan: “U ktheva nga Shqipëria në Athinë dhe ngrita zërin e protestës ndaj kësaj ç’ njerëzie të vërtetë, kështu duhej të veproja dhe dhashë dorëheqjen menjëherë si Ambasador i SHBA-ve për Greqinë dhe Malin e Zi, sepse kështu duhej të veproja, kjo nuk është veçse një detyrë njerëzore për t’i çjerrë maskën diplomacisë Europiane dhe të zbuloj faqen e saj të lyer me gjak të kësaj race heroike, Shqiptarëve, në gjykatën e diplomacisë e vërteta nuk është mbrojtje”.

Ambasadori Williams ishte mik i afërt i Presidentit Amerikan Woodrow Wilson i cili në kujtimet e Tij shkruan: “Ambasadori Williams më fliste përherë për Shqipërinë dhe Shqiptarët me respekt dhe dhimbje edhe kur dilnim për gjuhë ai nuk reshte për të më treguar për atë vend, saqë unë i thashë - boll më”.

George Fred Williams e rrëfen shpirtin e Tij si Shqiptarofil në librin e tij “The Skypetars-Shqiptarët”, ku përshkruan me saktësi të habitshme, originën, historinë, luftërat për liri të shqiptarëve.

Në fund të librit ai ka dy kapituj interesant të titulluar: “What can the United States do?” - “Çfarë duhet të bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës?” Dhe tjetri: “America Duty-Detyrimi i Amerikës”. Në këtë libër ambasadori Williams bën vlerësimin e pozicionit gjeostrategjik, rëndësinë strategjike që ka Shqipëria në Ballkan por edhe më gjerë në Europë.


Ambasadori Williams shkruan: “Nuk mund të mohohet se zotërimi i Shqipërisë ka qenë strumbullari i luftës në Kontinentin Europian, me dy fjalë, e tillë është historia e diplomacisë së Europës në vija të trasha, është si të thuash një parathënie që i shkon titulli: “Punët e liga të fuqive të mëdha ndaj këtij vendi të vogël”.

Ambasadori Williams bën një lutje për Shqipërinë: “Paqja dhe mirësia mes njerëzve të mbizotërojnë në tokë, kjo dritë rëntë tani edhe në Shqipëri, në Shqipërinë e vuajtur e të uritur në mes të lumit, e të etur për liri nën pemën e lirisë, fajtorë pa faj veç mbrojtëse e shtëpisë së vet”. Më tej Ambasadori Williams vazhdon: “Nuk ka përpjekje më fisnike për njeriun se sa ajo për lirinë kombëtare, të ndihmosh njeriun në të keq është bamirësi, e cila meriton të përshëndetet, t’i japësh lirinë një populli si shqiptarët do të thotë të japësh të drejta qytetare që veprën e sotme ta shtrish me mirësi të pafund dhe ta bësh atë të përjetshme.”

Ambasadori Williams i drejtohet opinionit në SHBA dhe thekson: “Opinionit në SHBA do t’i mbështesë dukshëm përpjekjet e Shqipërisë, prandaj mund të themi se shqiptarëve u është hapur dera e lirisë”.

Porse informacionet e Ambasadorit Williams një prej miqve më të ngushtë të Presidentit Amerikan Woodrow Wilson, edhe për shkakun se ishte një nga organizatorët më të zotë të fushatës elektorale të Presidentit Willson, i përkasin viti 1914, katër vite më pas në prag të fillimit të Konferencës së Paqes në Paris, analizat apo informacionet që i dërgoheshin për jetësimin e synimit të Tij ia kanë përgatitur të tjerë njerëz, ku gjithashtu përmes frazave të raporteve të përdorura për Shqipërinë përsëri lexohen pjesë të mendimeve e gjykimeve të shqiptarofil, ambasadorit Williams.

Presidentit Amerikan Woodrow Willson ka patur si përgjegjës të stafit të Tij prej 27 këshilltarësh, një personalitet dhe një njeri me kulturë dhe vizione të veçanta dhe jo më kot Presidentit Amerikan Woodrow Willson e mori dhe e përzgjedhi që të drejtojë fushatën e Tij elektorale dhe e fitoi garën për President të SHBA-ve, dhe ky është Dr. Isaiah Bowman.



Dr. Isaiah Bowman ishte gjeograf dhe edukator i shquar, drejtor i Shoqatës Amerikane Gjeografike (1915–1935) dhe më vonë President i Johns Hopkins University (1935–1948), si dhe këshilltar politik i Presidentëve Amerikanë Woodrow Wilson dhe Franklin D. Roosevelt.

Isaiah Bowman ishte drejtues i Institucionit Amerikan Gjeografik në kohën e presidentit Wilson, i cili luajti rol të rëndësishëm në politikën e jashtme amerikane dhe në hartimin e kufijve pas Luftës së Parë Botërore.

Dr. Isaiah Bowman ishte një gjeograf i njohur amerikan, i specializuar në hartografi dhe gjeopolitikë; u bë këshilltar i afërt i presidentit Willson gjatë Konferencës së Paqes në Paris (1919), ku ndihmoi në hartimin e kufijve të rinj pas Luftës së Parë Botërore.

Presidenti Amerikan Woodrow Wilson i ngarkoi Dr. Isaiah Bowman përgatitjen e raportit për Konferencën e Paqes në Paris, për një vit, së bashku me një staf të tërë këshilltarësh.

Presidentit Wilson e thotë shprehimisht se: “Raporti që përgatiti Bowman ishte vendimtar për përcaktimin e kufijve të disa shteteve të Europës dhe në veçanti të Ballkanit”.

Presidentin Amerikan Woodrow Wilson për ta rifreskuar informacionin për Shqipërinë të dhënë nga ambasadori Williams në vitin 1914 zgjodhi për këtë qëllim Konsullin Amerikan në Torino Josef Stavini, ky gjithashtu ishte një njeri me parime. Pasi mbërriti në Shqipëri të verifikonte në vend cilat ishin ndjenjat e shqiptarëve për SHBA-të dhe për fqinjët. Josef Stavini konstatoi se shqiptarët nuk ishin armiq me fqinjët, shqiptarët donin të kishin shtetin e tyre dhe nuk donin të shpërndaheshin nëpër shtetet e tjera fqinje.

Të gjitha këto konstatime të Konsullit Amerikan në Torino Josef Stavini i përmbledhi në një raport të hollësishëm të cilin e vuri në dispozicion të delegacionit amerikan pjesëmarrës në Konferencën e Paqes në Paris.

Presidenti Amerikan Woodrow Wilson u investua për çështjen Shqiptare duke parë se vetë Shqiptarët ishin të interesuar të kërkonin këtë mbështetje si i mbytur për ajër, këtë dëshirë jetësore të shqiptarëve ai e ka patur gjatë gjithë kohës përpara syve sepse menjëherë pas shpalljes së platformës prej 14 pikash që do t’i imponohej Konferencës së Paqes në Paris, në adresë të Presidentit Amerikan Woodrow Wilson nisën të mbërrijnë letra dhe telegrame të panumërta nga Shqiptarët kudo gjendeshin.

Një letër të firmosur nga Konstadin Kosta një student Shqiptar në Romë i kërkojnë Presidentit Amerikan Woodrow Wilson që, në kuadër të principeve të Tij të shpallura të merrte përsipër një mbrojtje efektive të Shqipërisë.

Në SHBA kishte tashmë një komunitet mjaft të organizuar me një peshë të caktuar, të cilët u përpoqën me të gjitha mundësitë e tyre për t’i shërbyer çështjes Kombëtare, ata shfrytëzuan çdo mundësi, mund të përmendim emra si Fan Noli, Motrat Qiriazi, Kristo Daka, Faik Konica, Mithat Frashëri, të cilët bënë përpjekje të pareshtura për të ndikuar që politika Amerikane ta shikonte objektivisht dhe në mënyrë miqësore të ardhmen e Shqiptarëve.

Disa grupe Shqiptarësh që rendën nga skaje të ndryshme të rruzullit, duke filluar nga Egjipti, Rumania, Bullgaria, nga Shqipëria shkuan drejt Parisit dhe secili sipas mundësive, njohjeve e lidhjeve përpqishin të sponsorizonin një mendim në favor të Shqipërisë.

Takimi i konfirmuar me Presidentin Amerikan Woodrow Wilson është ai i Fan Nolit gjatë kohës që organizohej një ceremoni pritje në bordin e anijes “My lowers”, duke lundruar në lumin Potomak, ku do të shkohej të bëhej një homazh tek varri i George Washingtonit, Noli ndodhej afër zonjës Willson dhe në bisedë e sipër i kërkon Zonjës Willson që të ndikonte tek i shoqi, Presidenti Willson që parimet e shpallura prej tij prej 14 pikash të zbatoheshin për sa i përket Shqipërisë.

Presidenti Amerikan Woodrow Wilson, i cili ndodhej shumë pranë i thotë Nolit: “Po zotëri, unë do të bëj përpjekje dhe atë zë që unë kam në Konferencën e Paqes në Paris për të folur do ta përdor edhe në dobi të Shqipërisë”.

Zhvillimet e mëvonshme treguan se Presidenti Amerikan Woodrow Wilson i mbeti konsekuent angazhimit të Tij për ta mbrojtur dhe mbështetur çështjen shqiptare. Amerika dhe Presidenti Woodrow Wilson ishin mbështetja vendimtare për Shqipërinë, duke siguruar tërësinë territoriale të Atdheut tonë, kjo tërësi territoriale që ekziston edhe në ditët tona.

Ia vlen të përsëritet një paragraf i ambasadorit amerikan George Williams, ku Ai ndër të tjera thekson se: “Nuk ka përpjekje më fisnike për njeriun se sa ajo për lirinë kombëtare, të ndihmosh njeriun në të keq është bamirësi, e cila meriton të përshëndetet, t’i japësh lirinë një populli si shqiptarët do të thotë të japësh të drejta qytetare që veprën e sotme ta shtrish me mirësi të pafund dhe ta bësh atë të përjetshme”. Faktet kanë treguar dhe po tregojnë se mbështetja e SHBA-ve për Kombin Shqiptar ka qenë është dhe do të jetë e pandryshueshme dhe e përjetshme.

Sekretarja e Shtetit e SHBA-së, Hillary Rodham Clinton, në fjalimin për përkujtimin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë në Parlamentin e Shqipërisë, më 01 nëntor 2012 theksoi:

“Jam këtu sot, në këtë moment historik në historinë e kombit tuaj, me një mesazh për të gjithë popullin e Shqipërisë. Shtetet e Bashkuara qëndruan me ju për 100 vitet e para të pavarësisë dhe do të qëndrojmë me ju për 100 vitet e ardhshme, dhe 100 vitet pas kësaj, dhe 100 vitet pas kësaj”.

Me rastin e 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve SHBA-Shqipëri, Zyra e Zëdhënësit të Departamentit të Shtetit, më 28 korrik 2022, publikoi një Fletëpalosje me Fakte e titulluar: “100 Vjet Marrëdhënie SHBA-Shqipëri”, ku ndër të tjera shkruhet:

Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria përkujtojnë 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve SHBA-Shqipëri në vitin 1922. Pavarësisht ndërprerjeve të këtyre marrëdhënieve gjatë shekullit të kaluar, dy vendet tona krijuan lidhje të forta, kapërcyen konfliktet dhe vështirësitë dhe u shfaqën si aleatë dhe miq të ngushtë. Duke pasur parasysh këtë histori, ne



shikojmë drejt së ardhmes dhe gjithçkaje që mund të arrijmë së bashku gjatë shekullit të ardhshëm. Dy kombet tona janë të rrënjosura në një angazhim të përbashkët për vlerat demokratike, paqen dhe prosperitetin ekonomik, të cilat janë themeli i këtij partneriteti të qëndrueshëm.

Temat e 100-vjetorit pasqyrojnë këto përparësi: Miqësia, Demokracia, Mbrojtja dhe Biznesi.

Miqësia

Deklarata jonë e Përbashkët e vitit 2015 mbi Partneritetin Strategjik midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë u bazua në vlerat e përbashkëta demokratike, respektin për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

Shtetet e Bashkuara ofruan ndihmë humanitare për Kryqin e Kuq Shqiptar dhe UNICEF-in pas tërmetit të vitit 2019, dërguan ekspertë zjarrfikës për të ndihmuar gjatë zjarreve të vitit 2021 dhe ofruan më shumë se 4.4 milionë dollarë ndihmë për COVID-19 për shpërndarjen e vaksinave, komunikimin e riskut dhe angazhimin e komunitetit. Studiues dhe studentë shqiptarë kanë bërë kërkime, kanë dhënë mësim ose kanë studiuar në universitetet amerikane përmes Programit “Fulbright” në Shqipëri, i themeluar në vitin 1991. Studiues dhe studentë amerikanë kanë udhëtuar në Shqipëri për projekte kërkimore dhe mësimdhënie. Në vitin 2021, 91 shqiptarë erdhën në Shtetet e Bashkuara përmes Programit të Vizitorëve të Shkëmbimit të Sektorit Privat (BridgeUSA) të Departamentit. Një Memorandum Mirëkuptimi i vitit 2019 financoi bashkërisht Programin e Studentëve “Fulbright”, duke zgjeruar bursat për studentët shqiptarë për të ndjekur studimet master në Shtetet e Bashkuara.

Që nga viti 1992, qeveria e Shteteve të Bashkuara ka ofruar më shumë se 1 miliard dollarë ndihmë për Shqipërinë për të mbështetur pluralizmin politik, shoqërinë civile, qeveritë lokale efektive, median e pavarur, sundimin e ligjit, sektorët e energjisë dhe shëndetësisë, sistemet ekonomike të tregut të lire, dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike, duke përfshirë zhvillimin e turizmit dhe partneriteteve të mikro-ndërmarrjeve.

Demokracia

Një shtyllë e marrëdhënies së fortë dypalëshe është një angazhim i përbashkët ndaj demokracisë. Mbështetja e Shteteve të Bashkuara do të vazhdojë për reformën në drejtësi, shoqërinë civile, median dhe procesin zgjedhor të Shqipërisë.

Mbrojtja

Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria ndajnë një partneritet dhe angazhim të fortë ushtarak në NATO, organizatë të cilës Shqipëria iu bashkua në vitin 2009.

Ndërmjet viteve 2003 dhe 2013, gati 4 000 trupa shqiptare punuan së bashku me forcat e NATO-s si pjesë e Operacionit Liria e Qëndrueshme dhe Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës për Sigurinë në Afganistan. Forcat shqiptare dhe amerikane qëndrojnë pranë njëra-tjetrës edhe në misionin KFOR të NATO-s në Kosovë.

Shqipëria ishte një nga vendet e para që mirëpriti mbi 2 500 të evakuuar afganë pas marrjes së pushtetit nga talebanët në vitin 2021. Qeveria e SHBA-së dhe OJQ-të amerikane njohën kontributet e qeverisë shqiptare në ofrimin e strehimit të sigurt për ata që ishin në nevojë.

Në vitin 2021, Shqipëria ndihmoi në pritjen e “Defender Europe-21”, e cila integroi afërsisht 28 000 forca amerikane, aleate dhe partnere nga 26 vende në operacione pothuajse të njëkohshme në zona trajnimi në më shumë se një duzinë vendesh nga Baltiku, në Afrikë, në rajonet kritike të Detit të Zi dhe Ballkanit.

Shqipëria u zgjodh anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (KSKB) për periudhën 2022-2023. Prioritetet e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit përfshijnë adresimin e krizave globale, inkurajimin e zgjidhjes paqësore të konflikteve, partneritetin dhe ndërmjetësimin. Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara janë bashkë-anëtarë në KSKB për çështjet e Ukrainës.

Komanda e Operacioneve Speciale të SHBA-së për Evropën (SOCEUR) krijoi një seli të Forcave të Operacioneve Speciale me bazë të avancuar në Shqipëri këtë vit, me mbështetjen e plotë të qeverisë shqiptare dhe ushtrisë shqiptare.

Komanda Evropiane e SHBA-së (EUCOM) po ndihmon Shqipërinë të zhvillojë aftësitë e saj në NATO. Një ekip nga Brigada e 4-t e Ndihmës për Forcat e Sigurisë (SFAB) e Ushtrisë Amerikane po jeton dhe stërvitet së bashku me Forcat Tokësore Shqiptare për të përshpejtuar këto përpjekje.

Biznes

Në tetor 2020, Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi Ekonomik (MEC).

Tregtia dypalëshe midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë ishte 162.2 milionë dollarë në vitin 2021, 47% më shumë se vitin e kaluar. Eksportet jugore janë rritur me 61% dhe eksportet shqiptare janë rritur me 30% krahasuar me vitin 2020. Investimet e huaja direkte amerikane arritën gjithashtu një nivel të ri rekord në vitin 2021. Kohë të begata i presin investitorët amerikanë, ndërsa Shqipëria demonstroi avantazhet e saj si një destinacion investimi.

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AmCham Albania), e themeluar në vitin 2000, po rrit tregtinë dypalëshe, po promovon investimet e huaja në Shqipëri dhe po përmirëson imazhin e biznesit shqiptar në tregjet amerikane dhe ndërkombëtare përmes 220 anëtarëve aktivë që përfaqësojnë bizneset më produktive dhe të suksesshme në Shqipëri.

Në vitin 2022, Shqipëria dhe Grupi Ndërkombëtar Jones nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi mbi rrjetet dixhitale të sigurta. Mbështetja amerikane për Shqipërinë ka qenë e vazhdueshme dhe e shumë-dimensionuar, duke filluar me rolin historik të presidentit Woodrow Wilson në vitin 1919, kur ai kundërshtoi copëtimin e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris.

Ky akt u bë themel i një miqësie të gjatë mes dy vendeve, kjo mbështetje sot përveçse shihet si një kujtim historik dhe mirënjohje e respekti për Presidentin Woodrow Wilson, shihet si një aleancë moderne përmes NATO-s dhe marrëdhënieve të ngushta në të gjitha aspektet, të cilat çdo vend normal do t’i dëshironte t’i kishte në këto nivele.

***Specialist / Kërkues në Institutin e Kërkimit Shkencor Ushtarak Akademia e Forcave të Armatosura**

23 SHKURT 1945, Dita e Ringritjes së Marinës Ushtarake Shqiptare

Më 23 shkurt 1945, vetëm pak muaj pas çlirimit të vendit, Shqipëria hodhi një hap të rëndësishëm në konsolidimin e sovranitetit të saj: krijimin e Seksionit të Marinës Ushtarake Shqiptare. Ishte një akt me peshë strategjike dhe simbolike. Një vend i dalë nga lufta, me infrastrukturë të dëmtuar dhe me burime të kufizuara, vendosi të organizojë mbrojtjen e hapësirës së tij detare – një element thelbësor i shtetësisë.

Kjo datë shënon fillimin e ringritjes së Forcës Detare, duke rikthyer traditën e ndërprerë të një arme që kishte nisur të konsolidohej që në vitet '20, por që ishte shkatërruar me pushtimin e 7 prillit 1939.

Një seksion që hodhi themelet e flotës

Me vendim të autoriteteve shtetërore të kohës, më 23 shkurt 1945, u krijua Seksioni i Marinës Ushtarake Shqiptare, si strukturë organizative përgjegjëse për ndërtimin dhe administrimin e kapaciteteve detare të vendit.

Në krye të këtij seksioni u emërua kapiten i parë i marinës **Abdi Mati**, një oficer karriere me përvojë dhe formim profesional në Akademinë Detare të Livornos në Itali. Ai përfaqësonte një ndërthurje të rrallë të disiplinës perëndimore detare me përvojën e fituar në Luftën Nacional-Çlirimtare.

Seksioni i Marinës, që në hapat e parë, nisi të thërrasë dhe të aktivizojë specialistë të vjetër të detarisë shqiptare: Ndoc Gjelluci, Rudolf Bumçi, Anastas Qëndro, Avdulla Hoxha, Stefan Maliko, Osman Goga, Nazmi Mezini, Qemal Braka, Pali Carapuli, Mikel Nonaj, Stavri Çika, Rrapo Gjermani, Gaz Mazi e të tjerë. Ata përbënin kapitalin njerëzor mbi të cilin do të mbështetej ringritja e flotës.

Në një kohë mungesash të mëdha materiale, pasuria më e madhe ishte profesionalizmi dhe përkushtimi i këtyre kuadrove

Nga thellësitë e ujit në shërbim të atdheut

Një nga aktet e para konkrete të Seksionit të Marinës ishte nxjerrja nga uji e dy motoskafëve të mbytura gjatë luftës. Ishte një punë e vështirë teknike, e realizuar me mjete të kufizuara, por me vullnet të jashtëzakonshëm.

Më 15 gusht 1945, u bë përrurimi i hedhjes në ujë të dy motoskafëve trofe të riparuar, me numër bordi MS-10 dhe MS-12. Të armatosur me mitraloza të lehtë, ata nisën menjëherë patrullimin dhe ruajtjen e ujërave bregdetare në Vlorë dhe Sarandë. Kjo ditë konsiderohet si dita e ringritjes së Marinës Ushtarake Shqiptare, një moment kur Shqipëria rifitoi jo vetëm mjete lundruese, por edhe praninë aktive në det.

Një institucion i unifikuar kombëtar

Në vartësi të Seksionit të Marinës do të ishin kapitaneritë e porteve Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Sarandë, të krijuara më 3 prill 1945, si dhe portet dhe kantieri detar.

Marina Luftarake Shqiptare u konceptua si një institucion i unifikuar, që administronte dhe mbronte gjithë infrastrukturën bregdetare kombëtare. Në një vend me vijë bregdetare të konsiderueshme, kjo ishte një domosdoshmëri strategjike.

Deti nuk ishte thjesht hapësirë gjeografike; ishte korridor ekonomik, pikë kontakti ndërkombëtar dhe vijë mbrojtjeje. Krijimi i një strukture të organizuar detare ishte, në thelb, akt i konsolidimit të shtetit.

Rrënjët historike: nga “Shqipnia” te Komanda e vitit 1926

Historia e Marinës Ushtarake Shqiptare nuk nis në vitin 1945. Ajo i ka rrënjët në periudhën e konsolidimit të shtetit shqiptar pas shpalljes së pavarësisë.

Më 15 shkurt 1926, anija “Shqipnia” mbërriti në Portin e Durrësit, duke shënuar një moment të rëndësishëm për krijimin e flotës ushtarake kombëtare. Pak muaj më vonë, më 26 qershor 1926, u krijua Komanda e Marinës Ushtarake Shqiptare.

Por kjo strukturë u shkatërrua pas pushtimit të Shqipërisë më 7 prill 1939 nga Italia fashiste. Me shpërbërjen e institucioneve shtetërore, edhe marina pushoi së ekzistuari si forcë kombëtare.

Prandaj, 23 shkurti 1945 nuk ishte një fillim nga zero, por një ringritje – një vazhdimësi historike e



ndërprerë nga pushtimi.

Abdi Mati – figura e një epoke

Në qendër të kësaj ringritjeje qëndron figura e Abdi Matit. I diplomuar në Akademinë Detare të Livornos, ai kishte shërbyer për një periudhë të shkurtër në Marinën Mbretërore Italiane, duke përfituar përvojë profesionale në një nga traditat më të konsoliduara detare të Mesdheut.

Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, ai u rreshtua në formacionet partizane, duke arritur deri në detyrën e Komandantit të Batalionit të Tretë në Brigadën e Tretë Sulmuese.



Pas vitit 1945, ai do t'i përkushtohej për 28 vite Forcës Detare, duke shërbyer për shumë vite si komandant i saj dhe duke arritur gradën e kundëradmiralit. Karriera e tij mishëron procesin e profesionalizimit dhe institucionalizimit të marinës shqiptare në dekadat e pasluftës.

Nga seksion modest në flotë luftarake

Ajo që nisi si një seksion i vogël me mjete të kufizuara, u shndërrua gradualisht në një flotë luftarake të organizuar. Me kalimin e viteve, Forca Detare do të zgjerohej, do të modernizohej dhe do të merrte një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e kufijve detarë.

Por themelet e saj mbeten të lidhura me përpjekjen e vitit 1945: me vullnetin për të rindërtuar nga rrënojat, me disiplinën profesionale dhe me ndjenjën e detyrës ndaj atdheut.

23 Shkurti – një datë identitare për Forcën Detare

Për Forcën Detare të Republikës së Shqipërisë, 23 shkurti është më shumë se një datë historike. Është simbol i vazhdimësisë, i sakrificës dhe i profesionalizmit.

Në një kohë kur Forcat e Armatosura operojnë në një realitet të ri sigurie, të integruara në strukturat euroatlantike dhe me misionet e shumanshme, kujtesa historike mbetet element formues i identitetit ushtarak. Ringritja e vitit 1945 dëshmon se edhe në kushte të vështira, me burime të kufizuara, vendosmëria dhe profesionalizmi mund të ndërtojnë institucione të qëndrueshme.

Trashëgimi dhe përgjegjësi

Sot, ndërsa përkujtojmë 23 shkurtin 1945, nderojmë jo vetëm një akt administrativ, por një vizion shtetformues. Nderojmë brezin e detarëve që punuan për nxjerrjen nga uji të mjeteve të para, që patrulluan brigjet me motoskafë të riparuar dhe që hodhën themelet e një arme të rëndësishme të Forcave të Armatosura.

Trashëgimia e tyre është përgjegjësi për brezat e sotëm për të ruajtur profesionalizmin, për të forcuar kapacitetet dhe për të garantuar sigurinë detare të Republikës së Shqipërisë.

Sepse deti mbetet hapësirë strategjike, dhe Forca Detare mbetet një nga shtyllat e sovranitetit kombëtar. Dhe kjo histori, e nisur me “Shqipnia” në vitin 1926 dhe e ringritur, më 23 shkurt 1945, vazhdon të shkruhet çdo ditë nga uniformat blu të atdheut.

28 Shkurt 1998, Dita që Ndezi Flakën e Luftës për Lirinë e Kosovës

Konteksti historik dhe shpërthimi i luftës

Lufta e Kosovës (1998–1999) përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme historike në fundin e shekullit XX në Ballkan. Ajo shpërtheu më 28 shkurt 1998, pas sulmeve të forcave të Republika Federale e Jugosllavisë në fshatrat Likoshan dhe Qirez në rajonin e Drenicës, një zonë që konsiderohej vatër e rezistencës shqiptare. Lufta përfundoi më 11 qershor 1999, pas hyrjes së forcave paqeruajtëse ndërkombëtare në Kosovë dhe tërheqjes së forcave serbe.

Rrënjët e konfliktit datojnë më herët, veçanërisht pas shfuqizimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989 nga regjimi i Slobodan Milošević. Gjatë viteve '90, shqiptarët e Kosovës u përballën me diskriminim sistematik, largime masive nga puna, mbyllje institucionesh arsimore e kulturore dhe represion policor. Në këtë klimë represive u formua dhe u forcua rezistenca e armatosur.

Palët ndërluftuese dhe përshkallëzimi i konfliktit

Lufta u zhvillua mes forcave ushtarake dhe policore të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), e cila u organizua si forcë e armatosur për çlirimin e Kosovës.

UÇK-ja fillimisht veproi në mënyrë të shpërndarë, por me kalimin e kohës u organizua në zona operative dhe arriti të kontrollojë territore të caktuara. Përballë saj qëndronte një makineri ushtarake shumë më e fuqishme, me armatim të rëndë dhe mbështetje të strukturave shtetërore jugosllave.

Konflikti u përshkallëzua gjatë vitit 1998 me operacione të ashpra ushtarake në Drenicë, Dukagjin, Llap dhe zona të tjera. Fshatra të tërë u rrethuan dhe u bombarduan. Një nga momentet më të përgjakshme ishte masakra e familjes Jashari në Prekaz, që u bë simbol i sakrificës dhe i rezistencës shqiptare.

Ndërhyrja e NATO-s dhe dimensionit ndërkombëtar

Situata humanitare në Kosovë u përkeqësua ndjeshëm në fillim të vitit 1999. Pas dështimit të bisedimeve të Rambujesë, më 24 mars 1999, NATO filloi fushatën ajrore kundër objektivave ushtarake dhe strategjike të Republikës Federale të Jugosllavisë.

Bombardimet zgjatën 78 ditë dhe shënuan një ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake ndërkombëtare me qëllim ndalimin e spastrimit etnik dhe dhunës ndaj popullsisë civile shqiptare. Gjatë kësaj periudhe, forcat serbe intensifikuan dëbimet masive të shqiptarëve nga shtëpitë e tyre.

Më 9 qershor 1999, u nënshkrua Marrëveshja e Kumanovës, e cila parashikonte tërheqjen e forcave jugosllave nga Kosova. Më 12 qershor 1999 hynë në Kosovë forcat paqeruajtëse ndërkombëtare (KFOR), duke shënuar fundin de facto të luftës.

Pasojat humanitare dhe demografike

Lufta e Kosovës pati pasoja të rënda njerëzore



dhe materiale:

- Rreth 800 000 shqiptarë u dëbuan me forcë nga shtëpitë e tyre.
- Rreth 15 000 persona u vranë, ndër ta afërsisht 2 400 luftëtarë të UÇK-së, ndërsa pjesa tjetër civilë.
- Rreth 6 000 persona u raportuan të zhdukur gjatë dhe pas luftës.
- 1 653 persona ende konsiderohen të zhdukur.

Shumë fshatra e qytete u shkatërruan, infrastruktura u dëmtua rëndë, ndërsa ekonomia e Kosovës u rrënua pothuajse plotësisht. Përveç dëmeve fizike, lufta la pasojë të thella psikologjike dhe sociale në popullsinë civile.

Roli i Ushtrisë Shqiptare dhe mbështetja kombëtare

Gjatë luftës, Ushtria Shqiptare luajti një rol mbështetës, veçanërisht në aspektin logjistik dhe humanitar. Territori i Shqipërisë shërbeu si bazë për strehimin e qindra-mijëra refugjatëve të dëbuar nga Kosova.

Kampi i Kukësit dhe zona të tjera kufitare u kthyen në qendra humanitare ndërkombëtare. Ushtria Shqiptare, në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare, siguroi rendin, furnizimin dhe asistencën për popullsinë e zhvendosur.

Kjo periudhë forcoi ndjenjën e solidaritetit kombëtar dhe bashkëpunimit ndërshtetëror.

Rëndësia historike dhe politike

Lufta e Kosovës ndryshoi rrënjësisht realitetin politik në rajon. Pas përfundimit të luftës, Kosova kaloi nën administrimin ndërkombëtar të OKB-së. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë, duke hapur një kapitull të ri në historinë e saj shtetformuese.

Kjo luftë konsiderohet nga shqiptarët si luftë çlirimtare dhe si moment themelor në realizimin e aspiratës për liri dhe vetëvendosje. Sakrifika e luftëtarëve dhe e civilëve mbetet pjesë e identitetit kolektiv dhe e kujtesës historike kombëtare.

Lufta e Kosovës (1998–1999) ishte një konflikt me pasojë të thella politike, humanitare dhe historike. Ajo dëshmoi përballjen mes një populli që kërkonte liri dhe një regjimi që ushtronte represion sistematik. Ndërhyrja ndërkombëtare, rezistenca e armatosur dhe sakrifika e popullsisë civile çuan në një realitet të ri politik në Kosovë.

Për gazetën “Ushtria”, trajtimi i kësaj ngjarjeje historike ka rëndësi të veçantë, sepse nderon sakrificën e luftëtarëve, thekson rolin e forcave të armatosura dhe kujton përgjegjësinë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon.



KOLONEL (R) ARBEN DHULI

Përfshirja zyrtare e Korridorit VIII në infrastrukturën kritike ushtarake të NATO-s përbën një nga zhvillimet më të rëndësishme gjeostrategjike për Shqipërinë në dekadat e fundit. Një projekt i njohur prej kohësh si bosht transporti Lindje-Perëndim tashmë po merr një dimension të ri: ai po shndërrohet në një korridor sigurie për mbrojtjen kolektive të Aleancës. Vendimi i bërë publik pas Ministerialit të Ministrave të Mbrojtjes në Bruksel konfirmon një realitet të ri strategjik: Shqipëria nuk është më thjesht një vend tranziti, por një nyje me rëndësi në planet rajonale të NATO-s për vitet në vijim. Në një kontekst ku siguria në kufijtë lindorë të Europës ndikon drejtpërdrejt stabilitetin e Ballkanit, ky zhvillim rrit ndjeshëm peshën gjeopolitike të vendit tonë.

Çfarë do të thotë “korridor sigurie”?

Në praktikë, kjo nënkupton që infrastruktura përgjatë këtij boshti – portet, rrugët, hekurudhat – konsiderohet thelbësore për lëvizshmërinë ushtarake të Aleancës. Në kohë paqeje, krize apo konflikti, forcat aleate duhet të jenë në gjendje të lëvizin shpejt, të furnizohen dhe të dislokohen pa pengesa infrastrukturore apo burokratike. Korridori VIII përputhet natyrshëm me konceptin e ashtuquajtur “Shengen ushtarak”, një nismë europiane që synon të lehtësojë lëvizjen e trupave dhe pajisjeve brenda kontinentit, duke përshtatur infrastrukturën civile për përdorim dual – ekonomik dhe të sigurisë. Kjo është arsyeja pse deklaratimet institucionale e theksojnë Korridorin VIII si pjesë të arkitekturës së sigurisë dhe planeve rajonale të Aleancës. Ndërkohë, kanë nisur edhe përgatitjet për Samitin e NATO-s që do të mbahet në Tiranë në vitin 2027, në bashkëpunim me Sekretariatit e Aleancës në Bruksel.

Nga “Rruga Egnatia” te arkitektura euroatlantike

Historia e këtij boshti shkon më shumë se dy mijë vjet pas, tek Rruga Egnatia arteria romake që lidhte Adriatikun me Lindjen. Sot, Korridori VIII shihet si vazhdim modern i kësaj logjike ndërlidhjeje, duke bashkuar Italinë, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Bullgarinë deri në Detin e Zi. Në territorin shqiptar, ai shtrihet rreth 154 kilometra, nga kompleksi portual Durrës-Porto Romano drejt Elbasanit e Qafë Thanës e për të dalë në Maqedoninë e Veriut, duke u kryqëzuar me korridorin Adriatiko-Jonian. Projekte kyçe si rikonstruksioni dhe elektrifikimi i hekurudhës Durrës-Rrogzohinë e bëjnë këtë bosht një infrastrukturë moderne me potencial ekonomik dhe strategjik.

Dimensioni rajonal dhe bashkëpunimi BE-NATO

Pas Ministerialit të Ministrave të Jashtëm, (një format: Shqipëri, Itali, Bullgari, Maqedoni e Veriut, Rumania) u rikonfirmua edhe një herë angazhimi për zhvillimin e Korridorit VIII si prioritet për lëvizshmërinë ushtarake dhe ndërlidhjen rajonale. Financimi pritet të mbështetet nga instrumente europiane si CEF, IPA III dhe WBIF. Në një kontekst ku siguria në kufijtë lindorë të Europës ka implikime të drejtpërdrejta për Ballkanin Perëndimor dhe Detin e Zi, ky korridor merr një rol të shtuar në zbatimin e planeve rajonale të NATO-s dhe në mbrojtjen e infrastrukturës kritike ndaj kërcënimeve hibride.

Në deklaratën e përfundimit të takimit, ministrat pjesëmarrës deklaruan se: “Rikonfirmojmë angazhimin tonë të fortë ndaj Korridorit VIII si prioritet për rritjen e lëvizshmërisë ushtarake, qëndrueshmërisë dhe ndërlidhjes, në kuadër të bashkëpunimit të forcuar BE-NATO, duke kontribuar drejtpërdrejt në sigurinë e krahëve juglindorë dhe lindorë të Aleancës, si në kohë paqeje, ashtu edhe në kohë krize dhe konflikti.

Theksojmë se përmirësimi i ndërlidhjes dhe mbrojtja e infrastrukturës përgjatë Korridorit VIII kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e Planit Rajonal të NATO-s dhe forcojnë aftësinë kolektive për të mbrojtur infrastrukturën kritike, si dhe për të parandaluar dhe për t’iu përgjigjur kërcënimeve hibride, dezinformimit, migracionit të parregullt dhe ndikimit keqdashës të palëve të treta, në një mjedis sigurie ku zhvillimet përgjatë kufijve lindorë të Europës kanë implikime të drejtpërdrejta për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, Detit të Zi dhe Mesdheut, të cilat mbeten me rëndësi strategjike për NATO-n. Financimi përmes instrumenteve si CEF, IPA III dhe WBIF e lidh projektin me politikat e zgjerimit dhe kohezionit europian.

Korridori VIII – Në çfarë forme u shërben shteteve pjesëmarrëse?

Korridori VIII është një korridor paneuropian transporti që lidh **Detin Adriatik me Detin e Zi**, duke kaluar përmes Italisë, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë (me lidhje funksionale edhe me Rumaninë përmes porteve të Detit të Zi). Ai përfshin: Transport detar (Bari/Brindisi – Durrës – Varna/Burgas), Hekurudha, Autostrada, Infrastruktura

Korridori VIII, nga një bosht transporti në “korridor sigurie” të NATO-s, një zhvillim që e vendos Shqipërinë në hartën strategjike të sigurisë euroatlantike



energjetike dhe telekomunikacioni.

Italia - Si përfiton? Portat drejt Ballkanit dhe Azisë Qendrore, Rrit eksportet italiane drejt tregjeve të Evropës Juglindore. Forcon rolin e porteve si **Bari** dhe **Brindisi** si nyje logjistike. Diversifikon rrugët tregtare përtej Alpeve dhe Evropës Qendrore.

Për Italinë, Korridori VIII është një **zgjatim strategjik ekonomik drejt Lindjes**.

Maqedonia e Veriut - Si përfiton? Është vend tranzit (pa dalje në det). Fiton akses më të shpejtë në: Porto Romano (Adriatik), Portet bullgare (Deti i Zi), Tërheq investime në: infrastrukturë, zona industriale, logjistikë.

Për Maqedoninë e Veriut, korridori është jetik për integrimin ekonomik dhe rajonal.

Bullgaria - Si përfiton? Lidh Detin e Zi me Adriatikun. Forcon rolin e porteve si: Varna dhe Burgas; diversifikon rrugët tregtare drejt Italisë dhe Evropës Perëndimore; ul varësinë nga rrugët tradicionale veri-jug.

Për Bullgarinë, korridori është një instrument për zgjerimin e tregtisë ndërkontinentale.

Rumania (lidhje indirekte) - Edhe pse nuk është në boshtin kryesor, përfiton përmes: lidhjeve me portin e Konstancës; integritetit me rrjetet e Detit të Zi; rritjes së flukseve tregtare rajonale. Për Rumaninë, është një rrugë alternative dhe komplementare tregtare.

Siguria, Qëndrueshmëria dhe Lëvizshmëria Ushtarake

• Diversifikim i korridoreve strategjike

Diversifikimi i korridoreve strategjike nënkupton krijimin dhe zhvillimin e më shumë se një rruge kryesore transporti dhe komunikimi (rrugore, hekurudhore, portuale apo energjetike). Zvogëlon varësinë nga një aks i vetëm lindje-perëndim, duke shmangur rrezikun e bllokimit ekonomik apo logjistik në rast krizash; Rrit fleksibilitetin e qarkullimit të mallrave, njerëzve dhe energjisë; Forcon sigurinë kombëtare përmes shpërndarjes së rrjeteve strategjike në disa drejtime; Lehtëson integrimin rajonal dhe lidhjen me korridore ndërkombëtare europiane.

• Rritja e kontrollit territorial dhe logjistik në Ballkanin Perëndimor

Zhvillimi i infrastrukturës strategjike i jep shtetit një prani më të fortë në territor dhe në rrjetet rajonale; Përmirëson monitorimin dhe menaxhimin e flukseve tregtare dhe të transportit; Ul kostot logjistike dhe rrit efikasitetin e shpërndarjes. Forcon rolin e Shqipërisë si pikë tranziti në Ballkanin Perëndimor. Ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik të zonave përreth korridoreve.

• Rritja e aftësisë për reagim të shpejtë në raste krizash, konflikti ose emergjencash natyrore

Një rrjet i mirë strukturuar dhe i diversifikuar transporti rrit ndjeshëm kapacitetin për menaxhim emergjencash; Mundëson mobilizim të shpejtë të forcave të sigurisë ose ndihmave humanitare; Siguron alternativa transporti në rast dëmtimi të një aksi kryesor; Përmirëson koordinimin rajonal në situata krize. Redukton kohën e reagimit dhe impaktin ekonomik të ndërprerjeve.

Nga Rruga Egnatia në arkitekturën euroatlantike



Një moment historik për Shqipërinë

Siç e theksova edhe më lart, Korridori VIII nuk është më një projekt transporti. Ai po shndërrohet në një instrument ku ndërthuren integrimi europian, zhvillimi ekonomik dhe siguria kolektive. Në një rajon ku dinamika gjeopolitike është gjithnjë e më komplekse, Shqipëria po konsolidohet si pikë lidhëse midis Adriatikut dhe Detit të Zi, midis Ballkanit dhe arkitekturës euroatlantike.

Përfundim

Korridori VIII nuk është vetëm një projekt transporti; ai është një instrument strategjik i sigurisë kolektive. Duke rritur shpejtësinë e dislokimit, duke përmirësuar reziliencën logjistike dhe duke forcuar ndërveprueshmërinë me NATO-n dhe BE-në, ai kontribuon drejtpërdrejt në stabilitetin rajonal dhe në projektimin e forcës në Europën Juglindore. Për Shqipërinë, ky korridor përfaqëson një mundësi historike për të konsoliduar pozicionin e saj si nyje strategjike në arkitekturën euro-atlantike të sigurisë. Pyetja nuk është më nëse Korridori VIII do të ndërtohet, por sa shpejt dhe me çfarë vizioni strategjik do të shfrytëzohet.

TRANSFORMIMI NË INDUSTRINË ADS: Temat Kryesore të 2026

Industria e Aerospace, Defense, and Security (ADS) po përballlet me një vit vendimtar. Viti 2026 sjell një mjedis global të mbushur me tensione gjeopolitike, përparime teknologjike të shpejta dhe një fokus të shtuar mbi domene të kontestuara, ku siguria dhe mbrojtja po marrin dimensione të reja. Në këtë kontekst, kompanitë që operojnë në sektorët e ajrit, mbrojtjes dhe hapësirës duhet të përshtaten me një realitet të ri, ku transformimi është i pashmangshëm dhe strategjitë tradicionale nuk mjaftojnë më.

Gjeopolitika si motor i industrisë

Në vitin 2026, gjeopolitika vazhdon të jetë faktori kryesor që përcakton ritmin e investimeve dhe rreziqeve në industrinë ADS. Konfliktet rajonale, rivalitetet midis fuqive të mëdha dhe rritja e pasigurisë globale po i shtyjnë shtetet të rrisin buxhetet e mbrojtjes dhe të investojnë në teknologji të avancuara. Kjo krijon një mjedis ku kompanitë që ofrojnë zgjidhje inovative për mbrojtjen kombëtare janë më të favorizuara, ndërsa ato që nuk arrijnë të përshtaten rrezikojnë të mbeten prapa.

Teknologjitë që po riformësojnë mbrojtjen

Raporti i GlobalData identifikon dhjetë tema kryesore që pritet të kenë ndikim të madh në industrinë ADS. Ndër më të rëndësishmet janë teknologjitë kundër dronëve, sistemet e mbrojtjes nga raketat dhe lufta elektronike.

- Teknologjitë kundër dronëve po bëhen të domosdoshme, pasi dronët përdoren gjithnjë e më shumë si armë të lira dhe efektive në konfliktet moderne.

- Sistemet e mbrojtjes nga raketat po evoluojnë për të përballuar kërcënime më komplekse, duke përfshirë raketat hipersonike.

- Lufta elektronike po merr një rol qendror, duke u fokusuar në neutralizimin e komunikimeve dhe sistemeve të komandës së kundërshtarit.

Këto teknologji nuk janë thjesht shtesa, por po bëhen shtylla kryesore e strategjive të mbrojtjes.

Fituesit dhe humbësit e transformimit

Raporti parashikon se disa kompani do të dalin fituese nga ky transformim, falë aftësisë për të inovuar dhe për të investuar në teknologjitë e reja. Kompanitë që fokusohen në inteligjencën artificiale, mbrojtjen kibernetike dhe sistemet e integruara të mbrojtjes pritet të përfitojnë më shumë. Nga ana tjetër, ato që mbështeten ende në teknologji tradicionale dhe nuk arrijnë të përshtaten me ritmin e ndryshimeve do të përballen me rrezik të lartë dhe humbje të pozicionit konkurrues.

Parashikime komerciale dhe tregu i punës

Shpenzimet në industrinë ADS pritet të rriten ndjeshëm në vitin 2026, me fokus të veçantë në teknologjitë e avancuara. Investimet do të orientohen drejt sistemeve të mbrojtjes inteligjente, platformave hapësinore dhe zgjidhjeve të integruara për sigurinë kombëtare.

Në të njëjtën kohë, tregu i punës po pëson transformim: kërkesa për ekspertë në fushat e kibernetikës, inteligjencës artificiale dhe inxhinierisë së avancuar po rritet, duke krijuar mundësi të reja për profesionistët, por edhe sfida për kompanitë që duhet të sigurojnë talentin e duhur.

Si e përdorin raportin liderët e industrisë

Ky raport është një mjet strategjik për drejtuesit e industrisë, analistët dhe ekipet e inteligjencës konkurruese. Ai u mundëson të kuptojnë cilat tema do të kenë ndikimin më të madh, të vlerësojnë se si gjeopolitika dhe teknologjitë po ndryshojnë konkurrencën, të krahasojnë pozicionimin e kompanive ndaj temave disruptive dhe të identifikojnë rreziqet e mundësitë në zinxhirët e furnizimit. Në këtë mënyrë, raporti mbështet planifikimin strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm, duke ofruar një kornizë të strukturuar për vendimmarrje më të informuar.

Përfitimet për blerësit e raportit

Raporti u jep kompanive dhe institucioneve mundësinë të:

- Identifikojnë mundësi investimi bazuar në trendet tematike.

- Kuptojnë sfidat dhe mundësitë e lidhura me temat



më transformuese.

- Përcaktojnë cilat teknologji dhe fusha mbrojtjeje po marrin prioritet.

- Marrin vendime strategjike më të sigurta për vitin 2026.

Ai është i vlefshëm jo vetëm për kompanitë ADS dhe ofruesit e sistemeve mbrojtëse, por edhe për agjencitë qeveritare, ekipet e inteligjencës strategjike dhe konsulentët e industrisë.

Kompani që po udhëheqin transformimin

- RTX Corporation (Raytheon Technologies) – një nga liderët globalë në sistemet e mbrojtjes nga raketat dhe teknologjitë kundër dronëve. Kompania ka investuar në sisteme të avancuara për interceptimin e raketave hipersonike dhe për neutralizimin e dronëve të armatosur, duke e pozicionuar veten si një aktor kyç në mbrojtjen ajrore.

- Northrop Grumman – e njohur për zhvillimin e sistemeve të luftës elektronike dhe mbrojtjes hapësinore. Investimet e saj në inteligjencën artificiale dhe sensorët e avancuar po e bëjnë kompaninë një nga fituesit e transformimit teknologjik.

- Lockheed Martin – ka fokus të veçantë në sistemet e mbrojtjes raketore dhe platformat hapësinore. Kompania po punon në integrimin e teknologjive të reja për të përmirësuar aftësitë e mbrojtjes kombëtare dhe për të rritur efikasitetin e sistemeve të saj.

- BAE Systems – një aktor i fuqishëm në fushën e luftës elektronike dhe sistemeve të inteligjencës mbrojtëse. Investimet e saj në teknologjitë e komunikimit të sigurt dhe neutralizimin e sinjaleve të kundërshtarit po e bëjnë një lojtar të rëndësishëm në këtë domen.

- Thales Group – po investon në sisteme të mbrojtjes ajrore dhe teknologji hapësinore, duke u fokusuar në integrimin e sensorëve dhe komunikimeve të avancuara për mbrojtje kombëtare dhe ndërkombëtare.

Vendet që po investojnë fuqishëm

- Shtetet e Bashkuara – mbeten investitori më i madh global në teknologjitë e mbrojtjes. Fokus i veçantë është tek sistemet kundër raketave hipersonike, mbrojtja kibernetike dhe platformat hapësinore, duke e bërë

SHBA-në lider në inovacionin mbrojtës.

- Evropa – pas dekadash nën-investimi, vendet evropiane po rrisin ndjeshëm buxhetet e mbrojtjes. Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar po investojnë në inteligjencën artificiale, sisteme autonome dhe teknologji kuantike, me synimin për të forcuar kapacitetet e tyre dhe për të reduktuar varësinë nga SHBA.

- Izraeli – i njohur për sistemin “Iron Dome”, po vazhdon të investojë në mbrojtjen kundër raketave dhe dronëve, duke u bërë një shembull i qartë i inovacionit në fushën e mbrojtjes ajrore.

- Kina – po investon fuqishëm në teknologjitë hapësinore, luftën elektronike dhe dronët autonomë, duke synuar të rrisë ndikimin e saj global dhe të sfidojë dominimin e SHBA në fushën e mbrojtjes.

- India – po rrit buxhetet e mbrojtjes dhe po investon në sisteme raketore dhe teknologji hapësinore, duke u përprjekur të forcojë pozicionin e saj si një fuqi rajonale me ambicie globale.

Fituesit dhe humbësit e transformimit

Fituesit e këtij transformimi janë kompanitë që po investojnë në teknologji të avancuara dhe po përshtaten me mjedisin e ri të kërcënimeve. RTX, Lockheed Martin, Northrop Grumman dhe BAE Systems janë shembuj të qartë të kompanive që pritet të përfitojnë. Nga ana tjetër, kompanitë që mbështeten ende në teknologji tradicionale dhe nuk arrijnë të përshtaten me ritmin e ndryshimeve do të përballen me rrezik të lartë dhe humbje të pozicionit konkurrues. Në nivel shtetëror, vendet që nuk po investojnë mjaftueshëm në teknologji të reja rrezikojnë të mbeten prapa në balancën e fuqisë globale. Viti 2026 është një periudhë ku transformimi është fjala kyçe për industrinë ADS. Me tensione gjeopolitike në rritje, teknologji që po ndryshojnë lojën dhe një treg pune që po kërkon aftësi të reja, kompanitë dhe vendet duhet të jenë të gatshme të përshtaten dhe të inovojnë. Raporti i GlobalData, i kombinuar me shembujt konkretë të kompanive dhe vendeve që po investojnë fuqishëm, ofron një panoramë të qartë mbi mënyrën se si po riformësohet industria e mbrojtjes dhe sigurisë në nivel global.



BËHU PJESË

**E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË!**

Zgjidh një karrierë me mision.

Zgjidh sfidën, disiplinën dhe zhvillimin profesional.

Zgjidh të jesh pjesë e një ekipi që garanton sigurinë kombëtare dhe kontribuon në operacione ndërkombëtare.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kërkojnë të rinj dhe të reja me integritet, përkushtim dhe dëshirë për të shërbyer.

E ardhmja e sigurisë fillon me Ju.

Aplikoni dhe bëhuni pjesë e uniformës që përfaqëson krenari, përgjegjësi dhe besim!